

The lives of the Albanian seminarians in the Urban College

Abstract: *The Urban College in Rome is not only one of the long-running colleges that the Holy See and the Pope do take care for its advancement, but it is also one of the most successful ones.*

In this paper, the author deals in general with these two perspectives, i.e. the lifetime and success of this college, although the focus of interest is mainly on the destinies of the Albanian seminarians who have studied in this college.

In view of this goal we included in this paper our own research work by presenting a more or less complete list of respective biographical data (almost) of all those seminarians who came to the college from the Albanian speaking area up to the 1870s.

The use of existing scientific literature encouraged the author to undertake research at the Collegio Urbano Archives (& Biblioteca) (ACU) as well as at the Historical Archive of Propaganda Fide (ASPF) in Rome (24-30 October 2015). This research enabled the investigation, collection, selection and classification of the documentary material for the whole period in question. This paper is the result of such work, not at all easy or trouble-free. However, the author does not purport to have relayed thoroughly on the fate of about 120 Albanian seminarians in this college, who in the years to come gave their contribution to the further maintenance of the Christian faith and, generally, of the Roman Catholic Church in the North Catholic Albanian cultural area during the 17-19 centuries.

1. Fjalë hyrëse

Ideja, sendërtimi dhe mbarëvajtja e Kolegjit Urban (= lat. *Collegium Urbanum*, sot it. *Pontificio Collegio Urbano "De Propaganda Fide"*) janë pjesë e programit misionar largvajtës, i syzuar si i tillë qysh në shpërgënjtë e aktivitetit të Kongregacionit të Propaganda Fide-s (: lat. [*Sacra*] *Congregatio de Propaganda Fide*; sot it. *Congregazione per l'Evangelizzazione dei Popoli*) e që konsiston në thelb në përkujdesjen dhe mbarështimin e besimit kristian, bash sipas amanetit të fundit të vetë pagëzuesit të tij: "Euntes in mundum universum, praedicate Evangelium omni Creaturae." (Marc. 16: 15) Bashkë kanë ditur, andaj edhe kanë mundur të mbijetojnë motet, duke parë, përjetuar e ndarë po së bashku ditë të mbara e të mbrapshta

në këta thujse plot katër shekuj (1627-2017).¹ Pra na mjafton të bëjmë një përlllogaritje fare të thjeshtë me mësuar se Kolegji Urban në Romë rezulton të jetë jo vetëm njëri ndër kolegjet më jetëgjatë që përkujdes dhe mbarësh-ton Kuria e Shenjtë dhe vetë kreu i saj Papa, por është edhe ndër më të suksesshmit, bash ashtu siç na prezantohet sot e gjithë ditën hijerëndë në gjelbërimin e përherëshëm të Gianicolo-s në krah të Vatikanit.

Asgjëmangut, në këtë shkrim synojmë t'u përmbahemi në vija të përgjithshme pikërisht këtyre dy perspektivave, pra jetëgjatësisë dhe suksesit të këtij kolegji, anipse fokusin e interesimit tonë e kemi vatërzuar shi në fatet që ka përjetuar ajo aradhë rishtarësh shqiptarë që kanë studiuar në këtë kolegji. Emrat e tyre për fatin tonë të mirë arrijmë t'i njehim qysh në fillimet e tij, sindëkur në vazhdimësi, meqë mëtojnë një farë dendurie konstante të paktën deri në fillimet e viteve 70-të të shek. XIX, kur institucioni i Kishës Katolike që vepronte atëbotë në hapësirën shqipfolëse u bë si të thuash zot i vetes, sepse filloi të përgatisë në truall të vet trurin intelektual-fetar shqiptar, bash në aulat e Kolegjit Saverian në Shkodër (17 tetor 1877).²

Përshektojme kështu të njëjtën hulli që kemi hapur e përkujdesur në dy shkrime të mëparshme lidhur me formimin intelektual-fetar të rishtarëve shqiptarë në kolegjet ilirikë të Femos (1664-1746: Demiraj 2015) dhe të Loretos (1591-1860: Demiraj 2016d; 2017a), duke i kumtuar lexuesit njëherësh qoftë dëshirën me gjeneruar sado përciptas pamje ende të panjohura në historinë ekleziastike të kulturës shqiptare përgjatë shek. XVI-XIX, ashtu edhe – madje sidomos (!) – kujdesin dhe respektin e nevojshtëm ndaj kujtesës historike kolektive, një detyrë kjo e gjithëshme morale-qytetare për rrethet e kudogjendura të inteligjencës shqiptare.³

E theksojmë këtë detaj të fundit, duke i mëshuar pra fort e qysh në fillim karakterit kryesisht njohës-enciklopedik të vetë këtij punimi, në të cilin pas një përshkrimi sado të thukët të rrethanave kulturore-fetare që nxitën dhe mundësuan hapjen e këtij kolegji, do të përqendrohemi shkurt në programin mësimor dhe jetën e përditshme në të, duke u ndalur së fundi edhe në do të dhëna të përgjithshme lidhur me historinë e tij deri në ditët tona. Në përputhje me këtë synim kryesor tonin, sikurse edhe me vetë hapësirën që mundëson revista "Shëjzat" për shkrime të kësaj natyre,

1 Datat me radhë të bulave të përftimit dhe stabilizimit të këtyre dy institucioneve janë: *Inscrutabili Divinae* dhe *Romanum decet* (22 qershor 1622); *Cum inter multiplices* (14 dhjetor 1622), *Cum nuper* (13 qershor 1623) e sidomos për kolegjin tonë *Immortalis Dei* (1 gusht 1627); shih: <http://www.vatican.va/roman_curia/congregations/cevang/documents/rc_con_cevang_20100524_profile_it.html>

2 Hollësisht Peters 2007 57vv.

3 Për përballjen me këtë problem sot në botimet akademike zyrtare, por dështake të tipit „Fjalor Enciklopedik Shqiptar“ (FESH bl. I-III, Tiranë 2008/9²: red. përgjegjës E. Lafa) shih së fundi Demiraj 2016c.

parapëlqejmë të ilustrujmë rastet që do të marrim në shqyrtim kryesisht me detaje të regjistruara për ata rishtarë që vinin në kolegji nga dy njësi administrative kishtare, siç janë Provinca (e dikurshme) Kishtare e Arbënit që rrokte gjithë hapësirën e Arqipeshkëvisë së Tivarit dhe të Durrësit bashkë me ipeshkëvitë e tyre sufragane, sikurse edhe Arqipeshkëvia e Shkupit që ngërthente si e tillë ngulimet me popullsi shqiptare dhe sllave të besimit katolik më përhapje kryesisht në Kosovë e Maqedoni. Ndihmë paraprake kemi përfituar në këtë rast sidomos prej konsultimit të tri punimeve balllore mbi Kolegjin Urban me autor Maksimiljan Jezernik (1971; 1973; 1975), të cilat përpos bibliografisë shteruese ravijëzojnë në përbërësit e vet themelore gjithë historinë e Kolegjit Urban deri në periudhën kur u hodhën në letër.⁴

Në funksion të po këtij qëllimi kemi përfshirë gjithashtu si pjesë kryesore e studimit punën tonë të mirëfilltë kërkimore, duke regjistruar në një listë pak a shumë të plotë me të dhënat biografike përkatëse (thujtje) të gjithë ata rishtarë shqiptarë që erdhën e mësuan në kolegji nga këto treva deri në vitet 70-të të shek. XIX. Shfrytëzimi i letërsisë shkencore ekzistuese e nxiti shkruenin e këtyre radhëve të ndërmerre (në 24-30 tetor 2015) hulumtime arkivore në Archivio (& Biblioteca) dell Collegio Urbano (ACU) sikurse edhe në Archivio Storico della Propaganda Fide (ASPF) në Romë,⁵ çka i mundësoi hetimin, mbledhjen, krehjen dhe klasifikimin e materialit dokumentar për gjithë periudhën në fjalë. Për ata klerikë të karrierës që arritën të ngjisinin katedrat e ipeshkëvive apo të arqipeshkëvive të ndryshme në Provincën Kishtare të Arbënit dhe në Arqipeshkëvinë e Shkupit ndihmoi dukshëm në mbledhjen e të dhënave biografike shtesë konsultimi i kompendiumeve themelore ekleziastike të natyrës enciklopedike, ndër to: "Hierachia catholica" (Eubel, bl. IV-VIII) dhe "Illyricum sacrum" (Farlati & Coleti bl. VII-VIII).

Rezultat i kësaj pune aspak të lehtë e aq më pak komode është bashky punim që i paraqesim lexuesit tonë sqimatar, pa mëtuar assesin një ezaurim tërësor e të patëmetë të fatit të rreth 120 rishtarëve shqiptarë në këtë kolegji, të cilët ndikuan më pas në shumësinë e vet në mbarëshkrimin e grigjës së krishterë e përgjithësisht të institucionit të Kishës Katolike Romake në Arealin Kulturor të Shqipërisë së Veriut katolik përgjatë shek. XVII-XIX.

4 Sh. edhe faqen zyrtare në internet: <<http://www.collegiourbano.org/it>>.

5 Me këtë rast shkrueni i këtyre radhëve i shpreh mirënjohje të thellë mikut dhe kolegut prof. Ardian Ndreca (Universitë Urbaniana), rektorit të Kolegjit Urban, mons. Vincenzo Viva si edhe zotit Giovanni Foschi në Arkivin Historik të Propaganda Fide-s, të cilët i mundësuan dhe lehtësuan vizitën dhe hulumtimin në këta arkiva.

2. Historik i shkurtër i Kolegjit Urban

2.1. Kolegji me fondacionet e veta

Një përshkrim sado i thukët i historisë së Kolegjit Urban vështirë se mund t'i anashkalojë dot emrit të Imz. Gianbatista Vives si ideator dhe mecen i themelimit të një kolegji që do të ishte nën vartësinë e drejtpërdrejtë të Kurisë së Shenjtë dhe vetë kreut të saj, Papës. Ishte kjo një ide që u vu shpejt në jetë, menjëherë pasi Vives bleu dhe i dhuroi Kongregacionit të Propagandës *Palazzo Fratini*-n,⁶ duke vënë gjithashtu në dispozicion për kolegjin e ri edhe ato mjete financiare, me të cilat mbështeste prej vitit 1603 deri 12 bursa studimi në Romë. Si ditë themelimi zyrtar e kolegjit njihet dt. 1 gusht 1627, kur Papa Urban-i VIII firmosi bulën “*Immortalis Dei Filius*” (shën. 1), duke marrë kështu në patronazh kolegjin e pagëzuar ndërkohë me emrin e vet si “*Collegium Urbanum*”. Duke filluar nga kjo datë, ky institucion pior do të jetë gjithherë në fokusin e vëmendjes dhe të përkujdesjes së veçantë të papëve të radhës. madje prej vitit 1647 do të gëzojë të gjitha ato privilegje që kishin përfituar falë traditës së gjatë kolegjesh të tilla si p.sh. Arciginasio Romano apo Collegio Greco etj.

Pas fondacionit Vives që mbështeste fillimisht studimin e 12 e më pas 10 nxënësve (= lat. *alumnus*, it. *alunno*), Papa Urban-i VII miratoi në shërbim të kolegjit edhe dy fondacionet Barberini me mecenë dy nipat e tij, vëllezërit kardinalë Françesco Barberini (i mirënjohur edhe me urdhërin *d'Onofrio*) dhe Antonio Barberini, të cilët financonin bursat e përkatësisht 13 dhe 12 nxënësve. Synimi i tri fondacioneve ishte kështu pak a shumë i njësuar: “Formimi i klerikëve shekullarë piorë, të përgatitur me qëllim që të propagandojnë dhe mbrojnë besimin katolik, duke sakrifikuar edhe jetën, në rast se do të ishte e nevojshme.” (Jezernik 1971 467) Përndryshe përbërja etnike e rishtarëve ishte e larmishme dhe rrokte si e tillë gjithë atë kornizë të uniadit kristian-katolik që njihte Kurinë e Shenjtë dhe primatin e saj, Papën. Kështu p.sh. bursa Vives ishte e destinuar për nxënës katolikë, pa dallim përkatësie etnike (përfjashto nxënës italianë). Ndër dy bursat Barberini ajo e d'Onofrio-s kishte për qëllim të mbështeteste nga dy bursantë të Kishave Gjeorgjiane, Persiane, Nestoriane, Jakobite, Melchite dhe Kopte; ndërsa e dyta parashikonte sipas rastit deri shtatë bursistë të Kishës së Abisinisë (Etiopi) dhe gjashtë të asaj Brahmane (Indi). Në ato rasa kur dy bursat e fundit nuk arrinin të ezauroheshin me rishtarë të rinj nga kishat në fjalë, vendet plotësoheshin me nxënës të Kishës Armene. Vështirësitë e rastit bënë që edhe nga këto bursa të përfitonin jo pak rishtarë që vinin prej vendeve ballkanike, pra edhe shqiptarë, të cilët vinin gjithsesi në kolegji kryesisht me bursën Vives, si p.sh. Gjergj Bogdani (nr. 13), Gjon Kampsi

6 Funksionon edhe sot e kësaj dite si seli e Kongregacionit me adresë zyrtare: Piazza di Spagna, 48 - 00187 Roma.

(Nr. 15), Ndue Vlladanji (nr. 32), Mëhill Kryeziu (nr. 45) etj.

Në fillim të shek. XVIII rritet numri i fondacioneve me syresh të tjera falë donacioneve të bëra nga Carlo Adda dhe Carlo Barberini që financonin përkatësisht pesë dhe dy bursa. Pesë bursa shtesë iu vunë në dispozicion vetë Kongregacionit të Propagandës prej trashëgimisë së Imz. Scanegato-s, ish-ipeshkëv i Avellino-s. Në regjistrin themelor nuk mungojnë gjithsesi as shënimet që njëri apo tjetri rishtar ballkanas a shqiptar hynte në kolegji me bursën Spinola (nr. 39, 43) e sidomos me të ashtuquajturën 'bursa Albani', padyshim një donacion ky i dhënë prej Papë Klementit XI. Ndër rishtarët shqiptarë që përfituan këtë bursë përmendim p.sh. Ndoin prej Shkodre (nr. 16) dhe Engjëll Logorecin (nr. 20). Këto rrethana të reja e të favorshme bënë që numri i nxënësve në kolegji të përjetonte gjithnjë rritje: nga 35 rishtarë në fillimet e veta deri në 65 syresh në gjysmën e dytë të shek. XVIII. Kuotën më të ulët të frekuentimit që çoi deri në mbylljen e përkohshme të tij, kolegji e përjetoi në fund të atij shekulli dhe fillim të shek. XIX (sidomos 1808-1815), pikërisht në vitet e revolucionit francez dhe pushtimit të Romës prej trupave të Napoleonit. (Jezernik 1972 285v.; 297v.) Rihapja e tij shoqërohet fillimisht me stabilizimin e kuotave të pranimit, të cilat pas vitit 1836 njohin vetëm rritje (deri 135 nxënës), pikërisht kur drejtimin e kolegjit e marrin në dorë etërit jezuitë. (Jezernik 1975 104)

Rritje të dukshme mësojmë të ketë përjetuar edhe elementi shqiptar në kolegji, sidomos përgjatë shek. XVIII. Kështu në shek. XVII (vitet 1633-1700) ndër 423 nxënës të regjistruar 14 rezultojnë me origjinë shqiptare (= 3,3%), ndërsa në shek. XVIII ndryshon raporti në 635 : 74 (= 11,6%). Përfitimi në këtë rast vinte përpos bursës Vives dhe asaj të Kongregacionit vetë, edhe prej bursash të tjera, si p.sh. ato të Carlo Barberini-t, Carlo Adda-s, Spinola-s dhe Albani-t. Vërejmë gjithashtu se në regjistrat themelore dhe katalogët e ndryshëm vjetorë të kolegjit nuk mungojnë as emra rishtarësh arbëreshë që i takonin ritit bizantin, si p.sh. <Giorgio Matranga> (RNCAPF I 352), <Demetrio Siculus Camarda> (= shq. Dhimitër Kamarda) nga Hora e Arbëreshëve të Sicilisë apo Vincenzo Dorsa (RNCAPF II 308) nga katundi arbëresh i Fraznitës (= it. *Frascineto*). Madje në një rast qëmtojmë edhe një nxënës të këtij kolegji prej kolonisë shqiptare, tashmë të asimiluar të Pianiano-s (Le Marche/Itali), shi <Michale Angelus Calmet>, i cili pasi përfundoi studimet në kolegji misionoi në Shqipëri, duke u ngjitur deri në katedrën e Ipeshkëvisë së Pultit. (Eubel VII 315)

2.2. Rregullorja e kolegjit

Organizimi i jetës dhe i aktivitetit të kolegjit ishte i parashikuar në detaje përkatëse në krerë të ndryshëm të rregullores, e cila sipas kohës e rastit përjetonte edhe ndryshime, përmirësime e shtesa. (Jezernik 1971 472vv.; 1975 108vv.)

I tillë ishte p.sh. rregulli i pranimit në kolegji (vetëm) për djelmoshë fizikisht të shëndetshëm, pa cene në trup e fytyrë dhe me sjellje të mira. Nuk duhej të kishin mbushur ende moshën 18 vjeç, në mënyrë që të kishin mundësi të fitonin pas një viti studimi statusin e nëndiakonit. Në këtë moshë ata duhet të kishin mësuar pak a shumë latinishten, krahas italishtes. Rishtarët shqiptarë paraqiteshin përgjithësisht në kolegji në moshë më të njomë, pasi nuk i kishin mundësitë e studimit të latinishtes dhe të italishtes në dioqezat amë, andaj edhe kryenin aty fazën përgatitore, e parashikuar kjo kryesisht për studimin e këtyre gjuhëve si lëndë të gramatikës. Përndryshe pranimi i mirëfilltë në kolegji shoqërohej me një test kualifikimi që e organizonte vetë kardinali përgjegjës i Kongregacionit të Propagandës së bashku me një anëtar që e caktonte po ky institucion. Fillimi i studimeve në kolegji shoqërohej gjithashtu me një fazë përgaditore, që zgjaste disa muaj e që mbyllej me kryerjen e sakramentit të Rrëfimit dhe betimin (§2.4).

Në rregullore parashikohej gjithashtu mospranimi në kolegji i kandidatëve që ishin në fakt të interesuar për të studiuar aty, por që kishin frekuentuar më parë kolegje urdhrash të ndryshëm fetarë në Romë. Po ashtu rishtarëve të pranuar në kolegji u ndalohej rreptësisht anëtarësimi në ndonjë urdhër fetar ose në organizime të çdo natyre tjetër, të paktën deri tre vjet pasi të kishin mbaruar studimet në kolegji. Kjo është edhe arsyeja përse dështoi, ndër të tjerë, edhe Pjetër Bogdani (nr. 4) me kërkesën e tij për t'u anëtarësuar në urdhrin jezuit. (Demiraj 2016b 30)

Në rregullore saktësohej në detaj edhe organizimi i jetës në kolegji, që fillonte në mëngjes me ngritjen me zile nga gjumi, rregullimin e shtratit e vafet përkatëse, me rendin dhe ritmin e lutjeve me gojë dhe lexim çdo ditë të vitit. Rëndësi kishte sigurisht prania në meshën e përditshme, pjesëmarrja e detyrueshme në programin mësimor dhe përgatitja individuale e mësimeve gjatë ditës, më tej koha e lirë, ditët e pushimit etj. Nxënësit gëzonin një ditë të lirë në javë si edhe dy periudha pushimesh në vit. Pikë kulmore në argëtimin e tyre ishte vizita në rezidencën papnore në Villa Albani.

Kujdes i veçantë i kushtohej në rregullore edhe modestisë në sjellje qoftë kundrejt eprorëve ashtu edhe në komunikim brenda e jashtë grupit, si edhe përpikmërisë në jetën e përditshme e në marrëdhënie me eprorët. Kërkesa të ngjashme i kërkohehin në rregullore edhe superiorit si “Padre Comune degli Alunni” sikurse personelit mësimor dhe administrativ të kolegjit, prej të cilit kërkohej gjithashtu korrektësi, rreptësi dhe përpikmëri në sjellje.

2.3. Formimi intelektual-fetar

Në rregullore ishte parashikuar edhe programi mësimor si synimi kryesor në jetën dhe veprimtarinë e kolegjit dhe bazamenti i misionimit

afatgjatë të rishtarëve “missi ad Fidem Propagandam”. Sapo i bashkoi kolegjit edhe dy bursat e kardinalëve Barberini, Papa Urban-i ngarkoi etërit teatinë me drejtimin dhe mbarëvajtjen e programit mësimor, të cilët më 1708 u zëvendësuan prej etërve lazaristë. (Jezernik 1972 290) Siç vërejtëm më lart, ndër privilegjet që gëzoi kolegji qysh në themelimin e tij si edhe me shtesat e bëra në vitin 1641 dallojmë p.sh. njohjen e të njëjtës shkallë kualifikimi të lartë me atë të Arciginnasio Romano, në të cilin ishte vetë rektori, sipas rastit prefekti i Kongregacionit, ai që kishte tagrin dhe përgjegjësinë me vendosur për fatin e nxënësve, përfundimin e studimeve deri në laureimin e tyre me gradën e doktorit. Konfliktet me rektorin përfundonin shpesh me përjashtime nga kolegji ose – rrallë e për mall (!) – me transferim në ndonjë kolegji që ishte në vartësi të drejtpërdrejtë prej Kongregacionit. I tillë është p.sh. rasti me Pjetër Bogdanin (nr. 4), si nxënës pas gjase paksa i sertë, i cili u detyrua të transferohej në Kolegjin Ilirik të Loretos (1648) me vijuar aty studimet, e të kthehej më pas shkurt në Romë (1651) vetëm sa për të marrë diplomën e doktorit (Demiraj 2016b 26vv., 33v.)

Një vëzhgim i shpejtë i programeve dhe i mbarëvajtjes së procesit mësimor lejon të përfundojmë se kolegji ofronte si programe bazë: lëndë humane, retorikë, filozofi dhe teologji. Në vitin 1649 u shtua në program edhe mësimi i gjuhëve orientale, ku nuk mësojmë gjë të jetë përfshirë edhe shqipja, edhepse Frang Bardhi (nr. 1) botoi dikur një fjalor latinisht-shqip (Romë 1635), kur ishte ende në bankat e kolegjit. (Demiraj 2016a 11v.) Programit i shtohen në shek. XIX edhe lëndë të shkencave natyrore dhe të mjekësisë, kur drejtimin e kolegjit e marrin përsipër etërit jezuitë. (Jezernik 1975 101)

Sipas kërkesave të natyrës didaktike ishin superiorë dhe mësuesit ata që vendosnin, cilat programe e kurse duhej të ndiqte njëri apo tjetri nxënës në veçanti. Po ashtu ishin profesorët ata që zotëronin metodikën përkatëse, sa i përket mësimdhënies, përsëritjes së temave të reja dhe diskutimit të çështjeve të ndryshme që zhvilloheshin në auditor. Ndër librat mësimorë dallonin autorë si Aristoteli, San Tomaso, Roberto Bellarmino, P. Zaccaria Bocceri. Po ashtu studioheshin aktet e koncileve të ndryshme provinciale e dioqezane, sidomos aktet e Konkilit të Trentos, si edhe libra doktrinarë, si p.sh. katekizmi roman i Bellarmino-s. Përpara dhurimit të urdhrave fetarë rekomandohej gjithsesi studimi i thelluar i Mistereve të Meshës, të Eukaristisë dhe shtatë Sakramentet. (Jezernik 1971 376)

Çdo ditë rezervohej edhe për studim privat: rreth 3,15 orë në dimër dhe 4,30 orë në verë. Edhe biblioteka e kolegjit erdhi duke u shtuar. Fillimisht kolegji kishte vetëm një raft me libra të dhuruar prej Kolegjit Gregorian më 1643. Por vetëm në fillim, se ja që më vonë ndodhi ajo që ndodh gjithmonë kur shtohen fondet: na shfaqet problemi i abuzimit me

librat, aq sa më 5 dhjetor 1667 Papa i radhës firmosi breven *Conservationi et manutentioni librorum bibliothecae Collegii de Propaganda Fide*, me anë të së cilës ndalonte, madje dënonte deri me skomunikim vjedhjen dhe dëmtimin e tyre. Kështu p.sh. nxënësit s’kishin më të drejtë as t’i merrnin librat me vete në dhomë, pa lejen ekskluzive të rektorit. A të ketë rënë dikur pre e këtyre veprimeve aspak të tolerueshme edhe ‘Meshari’ i Dom Gjon Buzukut, vende-vende i shqyer? Fakti që nëpër faqet e tij ndeshim jo rrallë zhgarravina, anëshkrime e deri edhe korrespondencë private midis lexuesish të pabindur, lejon të paktën ta hamendësojmë patëkeq edhe këtë opsion.

2.4. Betimi

Tumirja me vijuar studimet e rregullta në kolegji dhe prova e parë disamujore e aftësive të njërit apo tjetrit nxënës përfundonte zakonisht me betimin (= it. *giuramento*, lat. (*vetus*) *iuramentum*) si fazë e parë e mbarëvajtjes së studimit, një procedurë kjo më se e zakonshme në çdo kolegji fetar. Për kolegjin në fjalë sigloi, ashtu siç pritej, Papa Urban-i dora vetë. (Jezernik 1971 476v.) Në tekstin latinisht të betimit feksin si pika të veçanta që rishtari të zotohej, se: a) do të sillej konform rregullores së institucionit përkatës; b) nuk do të anëtarësohej në urdhra fetarë të çfarëdo lloji; c) do të ngjiste me sukses shkallët e karrierës meshtarake (: tonsura, katër urdhrat fetarë, subdiakonati dhe diakonati), duke e mbyllur studimin në kolegji me shugurimin me sakramentin e Urdhrit të Priftërisë; si edhe d) do të kthehej në dioqezën amë, ku kishte me iu nënshtruar pa naze, pra me bindje e përulje vendimeve që merrte (arqi)ipeshkvi përkatës ndaj fatit të tij. Dikur betimit iu shtua edhe e) detyrimi për t’i dërguar kongregacionit rregullisht relacione me shkrim mbi gjendjen e kishës dhe të grigjës katolike në terren. Për nxënësit e trevave të Europës ky detyrim ishte i përvitshëm, ndërsa për të tjerët çdo dy vjet. Obligimi për të kryer betimin nuk ishte aq i lehtë dhe u bë shpesh problem diskutimi në instanca të ndryshme të kongregacionit. Gjithsesi ai konsiderohej *perpetuo* “i përvitshëm”, pra edhe në rast se ishte kryer prej dikujt që nuk kishte mundur të ngjiste deri në fund me sukses shkallët e karrierës meshtarake, apo për një arsye a një tjetër ishte larguar, ase i ishin ndërprerë studimet.

Teksti i betimit ishte përgjithësisht i unifikuar në latinisht, përpos të dhënave personale dhe dioqezës amë prej nga vinte njëri apo tjetri rishtar. Ndonjë ‘lajthitje’ e rastit pas gjase edhe tolerohej. E tillë është p.sh. shtesa e bërë në një shqipe të pastër në fund të tekstit latinisht të betimit nga Pal Zogaj dora vetë (nr. 39) më 20 shtator 1752 /[...] Ego Paulus \Bria de/ Sogagni propria manu scripsi | E kam shkruar mbë kamb këtë bërë: jam prej Soganni/

2.5. Kapela Re Magi

Jeta shpirtërore dhe liturgjike brenda kolegjit kishte si pikë tërheqëse dhe rrezatuese kapelën e vetme në Romë kushtuar tre Mbretërve të Shenjtë (= <Re Magi>), të cilët përkujtoheshin në mënyrë të veçantë në kremën e Epifanisë. Pikë kulmore ceremonie të posaçme gëzonin edhe Rrëshajat. Ngjarje e veçantë ishte p.sh. festimi i kësaj kreme në vitin 1788, kur pjesëmori në festimet e rastit vetë Papa Piu VI, i cili u përshëndet në 24 gjuhë të ndryshme, ndër to edhe në atë të “nationi Epirotae”. (Jezernik 1972 287)

Shërbimeve të zakonshme liturgjike, u shtoheshin kohë pas kohe e rast pas rasti edhe funksione gjysmëzyrtare të Kurisë së Shenjtë, procesione të ndryshme, mesha mortu, përvjetorë festash fetare etj. Kapela fitoi me kohë emër të madh edhe jashtë mureve të kolegjit, duke u shndërruar në vend pelegrinazhi dhe vizitash, aq sa në ndonjë rast krijonte shqetësime e pakënaqësi sidomos te bordi drejtues i kolegjit. (Jezernik 1972 290v.)

2.6. Dritë-hije në jetën sociale në kolegji

Edhe dielli ka njolla, andaj jo gjithçka në jetën e brendshme sociale në kolegji shkëlqen ar në këta katër shekuj. Ndër shumë ngjarje që hedhin hije e zymtësi në jetën e kolegjit spikasin dy: a) gjendja shëndetësore e seminaristëve, që në mjaft raste ishte e paqëndrueshme, dhe b) pasojat e rënda që solli me vete pushtimit francez në kohën e Napoleonit.

Kështu, sa i përket gjendjes së rënduar shëndetësore, nuk ishin edhe aq të rralla mortet prej sëmundjeve të ndryshme epidemike, sidomos veremit (= it. *il male di etisia e gli attacchi di petto*). Këto ndodhnin herë në kolegji, herë në qendrat e kurimit në mal (Vigna) ose në Villa Albani, por edhe gjatë rrugës së kthimit ose kur seminaristët kishin mbërritur ndërkohë në dhe të vet, duke ndjekur kështu këshillën e njëkuptimshme të mjekëve. Sigurisht që edhe rishtarët shqiptarë nuk ishin aspak imunë këso rasash. Ndër ta mund të përmendim p.sh. Simon Bardhin (nr. 7) që arrin të paktën të shohë prindërit të fundit herë në dheun amë; apo Ndue Mehillin (nr. 17) që ndalesën e fundit e pati gjatë rrugës së kthimit, pikërisht në Zarë; sikurse Nikollë Melgushin (nr. 44) që dha frymën e fundit në Villa Albani; ase Mati Todrin (nr. 64) dhe Ndue Berishën (nr. 75) që ndërrojnë jetë në kolegji, etj.

Kur ndodhte mortu: 1) digjeshin të gjitha rrobat personale dhe pastrohej e dezinfektohej dhoma me themel; 2) për ata që dërgoheshin në shtëpi nuk magazinoheshin asnjë plaçkë e gjësend tjetër për t’iu shpërndarë më pas rishtarëve të rinj; 3) mënjanohesh pjesëmarrja në korr dhe mësim; 4) reduktohej ngrënia e mishit dhe shtoheshin cilësia e ushqimit të freskët, duke evituar djathin dhe peshkun në darkë e përgjithësisht yndyrnat; 5) urdhërohej larja e shpeshtë, sidomos pas shëtitjeve dhe kur shtohesh sëmundja.

Në jo pak raste dëshmohen edhe sëmundje mendore që vinin si rezultat i stresit të përhershëm në mësim, sidomos në lëndën 'e nëmur' të latinishtes, por edhe si pasojë e *mobbing* brenda në komunitet, që përfundonte deri në vetëvrasje. Jo rrallë lëvrinin lart-e-poshtë thashethemet, se gjoja jo gjithmonë pranohej në kolegji djelmuri e prerë për atë të shkretë shkollë. Madje në ndonjë rast dyshohej se mos ishte kryer betimi, duke mbajtur sytë poshtë dhe gëlltitur në heshtje faktin që të pranishmit as nuk kuptonin çfarë thuhej me zë të lartë apo shkruhej në librin e betimeve. Pra, jeta reale në komunitet rridhte disi ndryshe nga ajo shpirtërore dhe rregulli skollistik që kërkohej në letër.

Shfaqe të dënueshme në jetën e përditshme në kolegji nuk mund t'i klasifikojmë patjetër si ngjarje të jashtëzakonshme e që ndodhnin një herë në hënëz. Kështu p.sh. nuk ishin aq të rralla rastet, kur rishtarët i thërriste rektori në zyrë, madje do syresh i përcillte edhe në sekretarinë e kongregacionit, ku i hiqnin dhe i tërhiqnin veshin tamam, sepse hidhnin plehra nga dritarja apo pastronin xhepat e trajset me mbeturina në rrugë të madhe, apo bënë zhurmë gjatë celebrimit të meshës, në mos nuk silleshin siç u kishte hije në kisha dhe ambiente publike jashtë kolegjit. Dënimet këso rasash ishin të kategorive të ndryshme, duke filluar nga lënia pa vaft buke, ndalimi i daljes ditëve të djela, izolimi e deri përjashtimi nga kolegji.

Këtë masë të fundit e përjetonin gjithsesi vetëm ata rishtarë që ishin gatuar vërtet së prapthi. I tillë ishte p.sh. Gjon Mida (nr. 8) që u dëbua nga kolegji për natyrën e tij shtazarake. Me t'u kthyer në atdhe, hyri në milici. Por edhe aty Gjoni ynë nuk zuri karar dhe gjeti atë që e gjeti: "u zu me fjalë me një ushtar tjetër dhe mbeti i vrarë prej tij." Një fat të ngjashëm përjetoi edhe Ndreu prej Prizreni (nr. 14), i cili u përzu nga kolegji, se iu hakërrua në mexhlis mjeshtrit të shkollës publike. Ndërsa për Domenik Saçin (65) mësojmë në zërin e tij në regjistrin e përgjithshëm: „Stultus ut Luna mutatus est in fine Studiorum Sacra, ideoq. expulsus.“ (RNCAPF II 39)

Dikush tjetër që nuk shihte rrugëdalje tjetër për të mos u sjellë në vazhdimësi konform rregullores, pra që kishte probleme me eprorët ose në fund të fundit e kuptonte që mësimi në kolegji ishte kockë e fortë që nuk kapërdihej lehtë, kërkonte të largohej vetë. Prashtu Mark Mazreku (nr. 11) vuri oroe të paktën se nuk ishte gatuar për punë shkolle dhe kërkoi vetë me shkrim të kthehej në atdhe: kërkesa ju pranua, madje mënguan t'i vënë në dispozicion pa-një-pa-dy harxhet e rrugës. Një rrethanë të ngjashme mësojmë edhe për rishtarin 'dembel', më vonë studiuesin e mirënjohur arbëresh Vincenzo Dorsa, i cili ia gjeti anën largimit nga kolegji: ra i sëmurë në shtrat dhe dërgoi fjalë në familje se kishte dhimbje të forta në gjoks e se nuk i bënte mirë klima në Romë. Përndryshe eprorët e motivuan largimin e tij thjesht dhe vetëm me mungesën e dëshirës me përvetësuar

edhe latinishten, meqë gjithçka e kishte mësuar më parë në ghreqisht (RNCAPF II 308). Ndryshe u vendos për Pjetër Bogdanin (nr. 4), për të cilin mësojmë gjithashtu t'i kishte ardhur në majë të hundës rektori dora vetë, andaj donte të largohej një orë e më parë nga kolegji e të kthehej në atdhe. Kërkesa nuk iu pranua, por u gjet edhe një zgjidhje alternative: u vendos të vijoje studimet në Kolegjin Ilirik të Loretos. (Demiraj 2016b 26v.)

Ngjarje dhe vendime të kësaj natyre, që sot është vështirë t'i përtypësh pa rrudhur vetullat e vënë buzën në gaz, janë dëshmi e qartë e vrasamendjes së instancave eprorë, kur përballeshin atëbotë me halle e derte të kësaj natyre, duke analizuar dhe vendosur për çdo rast në veçanti. Prashtu lejohemi të përmendim si ilustrim të fundit rastin e Ndue Shllakut (nr. 108), i cili ishte bërë vërtet për hall se vetëm qortohej pa masë e cak nga eprori i vet në kolegji, aq sa s'duroi dot më dhe mori udhët drejt e te pashai turk. Ishte konsulli austriak që ia doli mbanë t'i prishë mendjen çastet e fundit dhe e ktheu tinëz në Romë. Kongregacioni e mori parasysh këtë rrethanë të pazakonshme dhe u tregua zemërgjerë, pra e lejoi Ndreun rebel të vijoje studimet në po atë kolegji, duke ndërruar pas gjase eprorin.

2.7 Revolucioni dhe pushtimi francez

Asgjëmangut, revolucioni francez e sidomos hyrja e trupave të Napoleonit në Romë përcollën pasoja katastrofale për kolegjin, meqë edhe Kuria e Shenjtë dhe kreu i saj Papa Piu VII që përkujdeseshin nga afër për të, u detyruan të mërgonin me lang e me plang, e bashkë me ta edhe kardinali prefekt di Petro (më 10 dhjetor 1809). Ndër letrat e shkresat e dokumentuara atëbotë rezulton gjithçka e dhunuar, e plasur pa rend nëpër magazina, e vjedhur ose e sekuestruar, apo e vënë në ankand për një copë bukë. Për më tepër seminaristët iu nënshtruan një diskriminimi të hapur publik. (Jezernik 1972 297v.)

Parë nga perspektiva e elementit shqiptar, nuk e kemi aspak të vështirë të përjetojmë bindshëm këtë periudhë vendnumëro deri kthim prapa të jetës në kolegji, që arrin pikë (dhe fazë) kulmore qysh në vitin 1798 (e në vazhdimësi deri në vitin 1815), kur problem jetik për seminaristët ende të pranishëm në kolegji u bë jo aq studimi dhe mbarëvajtja e tij, sesa gjetja e rrugëve dhe e mundësive për të shpëtuar kokën, pra kthimin shëndoshë e mirë në vendlindje. Ndeshtërasha të kësaj natyre përjetuan një numër rishtarësh shqiptarë, që u detyruan të liroheshin pa përfunduar studimet, ndër ta: Pjetër dhe Ndue Borci (nr. 77, 78), Ndre Negri (~ Ziu, nr. 79), Gjon Duka (nr. 80), Gjon Gashi (nr. 81), Nikollë Bardhi (82), Mark Lindi (nr. 87) e ndonjë tjetër. Fat disi më të mirë përjetoi në këto rrethana zindjellëse vetëm ndonjë rishtar si Dhimitër Muriqi prej dioqezës së Lezhës (nr. 86), që u lirua nga kolegji në maj 1798, pra do muaj para grupit të madh të rishtarëve shqiptarë (gusht 1798), duke zhvilluar dy muaj me radhë studim

intensiv në kursin e filozofisë në Castel S. Angelo e më pas mori edhe ai rrugën e ‘mërgimit’ për në dioqezën amë. Stacion ndërmjetës i kalvarit të mundimshëm të kthimit mprapsh pa letra ishte qyteti-port i Ancona-s, ku për rishtarët e këtij kolegji, sikurse edhe për ata të Kolegjit Ilirik të Loretos u përkujdes Kont Ndre Radovani (: it. *Conte Andrea Angeli Radovani*), i cili ushtronte atëbotë funksionin e Konsullit të Mbretërisë së Spanjës. (Demiraj 2016d 64v.)

2.8. Zhvillimet e mëvonshme

Rigjenerimi i marrëdhënieve të dikurshme të jetës në kolegji filloi të bëhej gradualisht vetëm pas rimëkëmbjes së shtetit papnor (1815), përkatësisht rikthimit në Romë të Kreut të Kurisë së Shenjtë së bashku me kardinalin prefekt. Kështu në vitet 1815-17 arrijnë të mblidhen gjithëgjithë 15 seminaristë bashkë. Veçse asnjë syresh nuk na rezulton të ketë qenë shqiptar. Deri në vitin 1821 kishin marrë shugurimin gjithëgjithë 22 misionarë të rinj “missi ad Fidem Propagandam”. (Jezernik 1975 100v.), por – siç edhe pritej – asnjë nuk rezulton të ketë qenë prej Provincës së Arbënit dhe Arqipeshkëvisë së Shkupit. Rishtari i parë shqiptar që kemi mundur të njehim pas zezonës së madhe është Gjon Krasniqi prej Dioqezës së Shkupit (nr. 88), i cili regjistrohet në kolegji më dt. 9 prill 1820. Rreth 30 rishtarë të tjerë shqiptarë e pasojnë Gjonin tonë deri rrokull viteve 70-të të atij shekulli, periudhë kjo, ku kemi vendosur pak a shumë edhe cakun kohor të hulumtimit tonë (§1).

Siç vumë në dukje edhe më lart (§2.1), kthesë për mbarë në jetën dhe aktivitetin e kolegjit, përkatësisht në organizimin e planit mësimor njohim sidomos pas vitit 1836 kur hyjnë dorëzanë për të etërit jezuitë me programin e tyre të mirënjohur *ratio studiorum*. Në shekullin në vazhdim – të cilin nuk e kemi bërë objekt studimi (!) – njohim vetëm rritje të numrit të seminaristëve që vinin nga e gjithë bota, çka solli natyrshëm edhe zhvendosjen e kolegjit prej Palazzo Fratini në Piazza di Spagna në ndërtesën e re madhështore në kodrën e blertë të Gianicolo-s pranë Vatikanit (më 24 prill 1931), ku jes e gjëllin hijerëndë sot e gjithë ditën. (Jezernik 1975 112vv.)

3. Elementi shqiptar në Kolegjin Urban

Kjo rubrikë e fundit ngërthen si pjesë e dytë dhe kryesore e studimit tonë regjistrimin e rishtarëve të Provincës Kishtare të Arbënisë dhe të Arqipeshkëvisë së Shkupit që u pranuan në kolegji gjatë viteve 1633-1875. Viti 1633 shënon edhe fillimin e regjistrimit të rregullt dhe mbarëvajtjen e rishtarëve në kolegji, bash ashtu siç shkruhet dhe ruhet në regjistrin themelor të kolegjit: “Registro dei nomi, Cognomi, etc. degli alunni di Propaganda Fide raccolti dal Rettore Bonvicini: ordinato poi il tutto da L.

IC Figari SJ” në dy vëllime (RNCAPF I/II) që ngërthejnë periudhën e viteve 1633-1850.⁷ Sistemimi i materialit të mbledhur në regjistër është bërë në bashkëvajtje informacionin e fituar në burime të tjera arkivore që kemi krehur dhe hulumtuar në ACU dhe ASPF (tetor 2015), duke dalluar ndër të tjera: a) katalogë të ndryshëm vjetorë që ruhen në mënyrë sporadike për vitet 1747-1761 (CAVCV) dhe rregullisht prej vitit 1818 (APCVPF, CACV, CATRCMD); b) në librin e betimeve (Giur. II⁸); si edhe c) në rubrika aktesh të ndryshme në ASPF, ku janë sistematizuar dokumente që lidhen me aktivitetin e kolegjit dhe marrëdhëniet administrative me sekretarinë e Kongregacionit të Propagandës (CP Coll Urbano vol. 20; SOCG vol. 361; 379 etj.); e së fundi d) kumte shtesë të fituara sidomos për meshtarë të karrierës në dy botime enciklopedike kishtarë: “Hierachia catholica” (Eubel, bl. V-VIII) dhe “Illyricum sacrum” (Farlati & Coleti bl. VII-VIII), por edhe e) falë studimeve të ndryshme të bëra botuara deri sot (sh. Bibliografi).

Në këtë listë që nuk mëtojmë assesi të ketë një ezaurim tërësor të gjithë inventarit të elementit shqiptar në kolegji për gjithë periudhën në fjalë, lexuesi i zellshëm dhe i interesuar përcjell dhe fiton informacion mbi emrat e (të paktën shumicës së) seminaristëve të regjistruar në kolegji së bashku me të dhënat biografike themelore, sikurse edhe mbi mbarëvajtjen e tyre deri në përfundim (ose jo!) të studimeve. Ai mëson sipas rastit edhe detaje shtesë për do ngjarje e rrethana që lidhen me jetën e njërit apo tjetrit rishtar në veçanti: betimin, lëvdatat, laureimin, shugurimin, meshat e para te celebruara prej tyre, karrierën klerikale, sikurse edhe ndeshtrasha të rastit: zullume, arrati, dënime, sikurse edhe sëmundje, ndarje nga jeta etj.; në fund të fundit gjithçka nga pak e me masë.

Dëshirë dhe lutje e natyrshme e shkruesit të këtyre radhëve është, që ti lexues ta çosh deri në fund këtë rubrikë. Shpreh kështu bindjen se edhe ti do t’i bashkohesh në mbyllje mendimit dhe përfundimit tim po aq të natyrshëm, se këtu jes dhe gjëllin gjithkund shumë e më shumë informacion pozitiv për gjithë ata rishtarë që i dhanë dorë, fuqi, jetë dhe shpresë besimit të krishterë në arealin kulturor të Veriut, një shkas ky tejet domethënës, pra një arsye më shumë për të mos lejuar kurrën e kurrës t’i anashkalojnë kujtesës kolektive historike në hapësirën kompakte shqipfolëse:

1. <Francesco Bianchi> (= shq. /Frang Bardhi/, lat. Franciscus Blanc(h)us): “[...] prej [Dioqezës së] Sapës; qe i pari nxënës i regjistruar në kolegji me themelimin e tij, duke filluar studimet më dt. 12 qershor 1633. Më dt. 1 shtator 1635 bëri betimin sipas formulës së parashikuar; u

7 Nuk kemi informacion për vitet e para 1627-1632, kur ishte zyrtarizuar ndërkohë kolegji si i tillë, por mungon çdo lloj akt-regjistrimi edhe në arkivat ekzistues (ACU dhe ASPF). Kjo është edhe arsyeja, përse emri i Frang Bardhit (nr. 1) ka hyrë në historikun e kolegjit si rishtari i parë i regjistruar në kolegji. (Jezernik 1971 470)

8 Vëllimin e parë të librit të betimeve nuk patëm mundësi ta konsultonim.

shugurua prift dhe më dt. 30 mars 1636 u konsakrua ipeshkëv i Sapës prej eminencës së tij, zotit Kard. Roccia në prani të Imz. Giovanni Battista Altieri, ipeshkëv i Camerino-s dhe të imz. ipeshkvit të Asti-t; më dt. 3 prill (1636) u nis për në selinë e tij [në Sapë – B.D.]” (RNCAPF I 1)⁹ Këto të dhëna regjistrohen me ndonjë detaj shtesë edhe në fund, në shtojcën e panumëruar të këtij regjistri: <Alunni all’ apertura del Collegio>.¹⁰

2. <Stefano Gaspari> (= shq. /Shtjefën Gaspri/): “[...] shqiptar; hyri në kolegji më dt. 12. qershor 1633 dhe ishte njëri ndër të parët studentë të këtij kolegji. Më dt. 1 shtator 1635 bëri betimin sipas formulës së parashikuar. Pasi pati përfunduar studimet në teologji u shugurua prift, [duke u vënë] në shërbim të Kongregacionit të Shenjtë, i cili e ngarkoi me drejtimin e një abacie në atdhe të vet, për ku u nis më dt. 12 qershor 1637.” (RNCAPF I, 2). Si në rastin e Frang Bardhit (nr. 1, shën. 9.) mësojmë edhe për Shtjefën Gasprin ndonjë detaj shtesë në fund të regjistrit, në shtojcën e panumëruar, si vijon: “2. Shtjefën Gaspri: sapo përfundoi studimet dhe mësoi rezultatet e [kursit të] teologjisë, u shugurua prift dhe me pëlqimin e Kongregacionit të Shenjtë drejton një abaci në atdhe, për ku u nis më dt. 12 qershor 1637.” Siç kemi vënë dukje në tjetër vend, Shtjefën Gaspri kishte qenë edhe më parë komilton me Frang Bardhin, kur studionin së bashku në Kolegjin Ilirik të Loretos.¹¹ Një pikë kulmore në karrierën e tij kishtare

9 ROQUES shënon gabimisht si datë nisjeje 8 prillin (1932a 25: “.. et le 8 avril il partait.”). Për periudhën e mëparshme të studimeve të tij në Kolegjin Ilirik të Loretos, si edhe për detaje të tjera të natyrës biografike shih së fundi DEMIRAJ 2016a 7vv., si edhe 2017a 22: “<Francesco Bianchi> (= /Frang Bardhi/): prej Zadrime; hyri në Kolegjin Ilirik (si) nëndiakon më 22 korrik 1628, në moshën 22 vjeç, duke bërë betimin një vit më vonë, shi më 8 prill 1629. U transferua më 15 maj 1633, bashkë me Shtjefën Gasprin (nr. 9) në Kolegjin Urban të Propaganda Fide-s në Romë me vendim të Kongregacionit të Shenjtë të Propagandës me studiuar aty teologji skolastike dhe morale. [3r = 74] Gjatë studimit në Loreto fitoi statusin diakonit në dhjetor të vitit 1632 prej Kardinal Roma-s në Recanati. [50v = 171]” Shtojmë me këtë rast që regjistrimi i Bardhit në veprën e natyrës enciklopedike “Hierarchia Catholica” (Eubel IV 305) është çoroditës, përkatësisht detajet e dhëna në shën. 6 të Ipeshkvisë së Sapës nuk korrespondojnë aspak emrin e Frang Bardhit, që është parashikuar në këtë shënim. Sh. edhe Farlati & Coleti VII 285vv.

10 Në këtë shënim mësojmë sa vijon: “1. Francesco Bianchi di Sappa in Albania fu il 1.º | ricevuto in Collegio nella sua erezione che seguì il 12 | giugno [12. Giugno - sic!] 1633. \a terminati gli studi e fatto Sacerdote,/ ai 30. marzo 1636. consagrato Vesco.º di Sappa dall’ Emmi. Card. Roccia col’ assistenza di Mons. Giov. Batt. Altieri Ves.º di Camerino e di Monsig. Vescovo di Asti.> [faqe e panumëruar – B.D.]

11 Khs. Demiraj (2017a – në shtyp): “/Shtjefën Gaspri/ prej Durrësi; hyri në Kolegjin Ilirik në Loreto më 1 shtator 1625. Betimin rezulton ta ketë bërë në vitin 1628. U transferua më 15 maj 1633 me vendim të Kongregacionit të Shenjtë në Kolegjin Urban në Romë për të studiuar aty teologji skolastike dhe morale. Është i pari ipeshkëv i Sapës që doli

është ngjitja në katedrën e ipeshkvit të Sapës në moshën rreth 62 vjeç më dt. 29 maj 1673. Ndërron jetë në detyrë shtatë vjet më vonë (14 shkurt 1680).¹²

3. <Marco Mediu> (= shq. /Mark Mediu/ ~ /M. Mesi/ ?): "[...] shqiptar nga zona e Pastroviq-it [dhe emër fisi në Mal i Zi – B.D.]; u pranua në kolegji më 1 prill 1642 rreth moshës 13 vjeç. Mësoi për gati dy vjet Doktrinën me bursë të Propagandës. Por u lirua me vendim të këtij institucioni më 23 qershor 1647. U nis për në atdhe më dt. 23 gusht, duke ju dhënë harxhet dhe ndërresat [e udhëtimit]." (RNCAPF I, 24) Hollësi për largimin e tij të parakohshëm nga kolegji nuk kemi mundur të mësojmë dot.
4. <Pietro Bugdano> (= shq. /Pjetër Bogdani/): "[...] shqiptar; hyri në kolegji më 13 shtator 1642; është në moshën rreth 15 vjeç." (RNCAPF I 25) Pjetri ynë qëndroi në këtë kolegji jo më larg se viti 1647, duke u transferuar më pas në kolegjin Ilirik të Loretos, ku i përfundoi studimet në vitin 1650. Në fillim të vitit 1650 kthehet për pak kohë në Romë për të mbrojtur laurean e doktorit e që andej niset më 17 maj të po atij viti për në dioqezën amë.¹³
5. <Antonio Vladagni> (= shq. /Ndue Vlladanji/): këtë emër nuk e ndeshim në regjistrin themelor (RNCAPF I/II), ku janë regjistruar përgjithësisht ata nxënës që kanë bërë betimin. E lexojmë vetëm në disa shënime të sekretarisë së Kongregacionit të Propaganda Fides të viteve 1650/1, kur ka bërë kërkesë për bursë me filluar studimet e mirëfillta në kolegji, pasi i kishte përfunduar me sukses në moshën 18 vjeç kurset e gramatikës, d.m.th. të njohjes dhe përvetësimit të latinishtes dhe italishtes.¹⁴ Gjithsesi, vendimi i marrë nga instanca përkatëse rezulton të ketë qenë negativ.¹⁵

nga bankat e këtij kolegji. [1r = 71-2] Gjatë studimit në Loreto iu dhuruan katër urdhrat minorë prej Kardinal Roma-s në Recanati në dhjetor të vitit 1633." [51r = 171]

- 12 Shih Eubel V 344: „Promovetur iuxta decr. S. Congr. Prop., c. disp. ... gradus (AC 22 f. 142) ; bulla prov. (S. Br. 1592 f. 100 ss.): nat. in civ. Dyrrachien., aet. 62 an. circ., alumnus coll. Urbani de Prop., caractere cler. insign. et prom. ad ord. min. 18 Dec. 1632 subdiac. ^{tus}, diac. ^{tus} (P. Dat. 1673 f. 109 ss.) ; decr. S. Congr. Prop. 28 Febr. 1673 emanatum et a S.S. 1 mart. approbatum (l. c.) ; consecr. Romae a Federico card. Sfortia 11 Iun. 1673 (Vat. Lat. 12336 f. 269); ob. 14 Febr. 1680 (Gams 416)." Sh. edhe Farlati & Coleti VII 289.
- 13 Hollësisht Demiraj 2016b.
- 14 SOCG vol. 361 fol. 4r: "Antonio Vladagni humiliss.^{mo} ore di V.E. giouane di 18 anni, Albanese, sotto il dominio del Turco, prouetto nella grammatica, desideroso di auanzarsi nella disciplina, e pietà xp[istia]na, supplica la benignità dell' E. V. a degnarsi di ammetterlo p[er] Alunno del Collegio di propaganda fide, che perpetuam.^{te} pregarà Dio [...]" Ky rishtar nuk do ngatërruar me adashin e vet një shekull më vonë. (nr. 32)
- 15 Kështu, në këtë vendim, ndër të tjera lexojmë: "[...] In co[n]formità di molte istanze

6. <Michele Crisio \Neri/*> (= shq. /Mëhill Kryeziu/ ~ /M. Ziu/ ?): “[...] prej Zadrime në Dioqezën e Sapës në Shqipëri; i lindur prej martese legjitime me prindër katolikë. U transferua në kolegji më 15 mars 1656, duke qenë në moshën rreth 15 vjeç, pa ditur me parë shkrim e këndim. Bëri betimin më 1 janar 1659. U shugurua prift më dt. 12 gusht 1667, pasi kishte përfunduar studimet në filozofi dhe teologji. U kthye për në atdhe, duke marrë edhe harxhet e rrugës me veshjen përkatëse. Nuk shfaqti ndonjë aftësi të veçantë, madje ishte dënuar disa herë me izolim. | [Shën.] *Kështu thirret emri italian i familjes *Neri*. <Crisio> në italisht do të thotë “neri” [= shq. *i zi*].” (RNCAPF I 80)¹⁶
7. <Simon Bianchi> (= shq. /Simon Bardhi/): “[...] prej qytetit të Shkodrës në Shqipëri; lindur në mënyrë legjitime prej prindërish katolikë. Hyri në kolegji më 6 mars 1660 në moshën plot 18 vjeç. Studioi pak gramatikë. Më 16 korrik 1661 u largua nga kolegji me këshillë të mjekëve dhe u dërgua për në atdhe.” (RNCAPF I 87)
8. <Gio[uanni] Mida> (= shq. /Gjon Mida/ ~ /Gj. Midha/?): “[...] prej Gjadri në Dioqezën e Sapës në Arbëni; lindur në mënyrë legjitime prej prindërish katolikë; u pranua në kolegji më 2 dhjetor 1660, duke qenë në moshën 18 vjeç. Dinte diçka të shkruante dhe lexonte, por, duke u gjykuar si i paaftë për t’u regjur në punë letrash dhe për natyrën e tij shtazarake, u dëbua nga kolegji më ... [lënë bosh – B.D.] qershor 1663, duke i dhënë me vete harxhet e rrugës. Kishte bërë betimin në vitin 1662. Pasi u kthye në atdhe aplikoi për në milici në shërbim të venecianëve. Por edhe aty nuk gjeti karar. U zu me fjalë me një ushtar tjetër dhe mbeti i vrarë prej tij.” (RNCAPF I 89)

fatte all’ E.E.V.V. d’ Antonio Vladagni Albanese circa d’ottenere un luoco nell collegio de propaganda fide oue in puochi anni hauerebbe finito li suoi studi , ma p[er] carestia di luochi no hauendo otener la gra[tia], et no potendo qui piu dimorare, et tutta l’humittà riccore alla paterna piettà dell’ E.E.V.V. accio restassero seruite di souenirlo, et qualche poco di uiaticio, et che à pena si puotesse transferire alla patria et Deus.” (SOCG vol. 361, fol. 5r: L. Mem. 1650, nr. 2)

- 16 Këtë emër e hasim jo rrallë edhe në fondet e ASPF SOCG 379 fol. 14, 180; 361 fol 28. Në SOCG 379 fol 248 lexojmë edhe kërkesën e tij me shkrim, datuar më dt. 28 shkurt 1662, me u larguar nga kolegji për arsye personale, si vijon: “[...] Io Michele Neri Albanese deuot.^{mo} Ser.^{re} delle V.^{re} Emin.^{ze} con ogni maggior humiltà supplicando espone, come essendo la sua casa caduta nelle mani dei Turchi per cagione di molti infortunij, & hora si ritroua in pericolo di affatto perdersi; & essendo ancora il Padre del sud.^{to} Michele morto nello stato Venetiano lasciando alcuni beni nelle altrui mani, e perche Eminentis.^{mi} Sig.^{ri} l’uno, e l’altro caso stano in grandissimo pericolo di perdersi del tutto, alche n[?] ui è chi soccorra, per tanto ricorre alle Emin.^{ze} V.^{re} humilmente supplicandole á degnarsi di licenziarlo dal Collegio usando con quelle gratie, che hanno usate uerso li altri Alunni, che lo riceuerá á gratia Sing.^{ma} dall’ Eminenze V.^{re} Quam Deus &”

9. <And[re]a Gallata> (= shq. /Ndre Gallata/): “[...] prej Durrësi në [Provincën Kishtare të] Maqedoni[së]. Lindur prej prindërish katolikë. Hyri në kolegji më dt. 15 tetor 167[?], në moshën 18 vjeç, duke ardhur prej kolegjit të Fermos,¹⁷ ku kishte mësuar për katër vjet gramatikë. U largua më dt. ... [lënë bosh – B.D.]; [nxënës] me aftësi të kufizuara; por një i ri me sjellje të mira dhe i prirur për bamirësi. Bëri betimin e zakonshëm më 29 dhjetor 1673.” (RNCAPF I 125) Është pikërisht sjellja e përlulët dhe shpirti bamirës që e bëri të ngjisë katedrën e ipeshkvit në Dioqezën e Shkodrës më dt. 16 shtator 1686, kur sapo kishte mbushur moshën 30 vjeç. Këto dhe detaje shtesë – p.sh. vendlindjen e tij Kurbinin – i mësojmë te Eubel (V 347).¹⁸
10. <Pietro Massarech> (= shq. /Pjetër Mazreku/): këtë emër nuk e ndeshim në regjistrin themelor (RNCAPF I/II), por rezulton në akte të ASPF si nxënës i kolegjit, i shuguruar ndër kohë prift e që kërkon lejën për t’u kthyer në atdhe më dt. 23 mars 1669, duke u pajisur edhe me një numër librash të nevojshëm, ndër të cilët feks një doktrinë e krishterë shqip [e Pjetër Budit] si edhe fjalori shqip [i Frang Bardhit], si vijon:

“23 martij 1669 | Em.^{mi}, e Reu.^{mi} Sig.^{ri} | Pietro Massarechi Albanese Alunno Sacerdote del Uen. Coll.^o Urbano hauendo supplicato della licenza di ritornare al paese, e compiacendosi l’EE. VV. d’esaudire l’oratore desidererebbe riceuer gratia dell’infrascritti libri. | La Sacra Scrittura in latino piccolo | Il Missaletto Romano in latino | L’Euangelij Arabici | Triumphus Crucis Sauon[???]le | La Fabrica grande arabica | Arte di ben morire in illirico | Messale illirico | Dittionario illirico | Dottrina Christiana Albanese | La uita di Christo illirica | Dottrina Christiana

17 Në regjistrat e Kolegjit Ilirik të Fermos, rezulton të ketë qenë i regjistruar vetëm <Giovanni Galata> “(= shq. /Gjon Gallata/ ?) nga Kurbinin në Dioqezën e Durrësit: kreu studimet në periudhën 10.5.1695 – 7.11.1703. U zgjodh ipeshkëv i Sapës.” (Demiraj 2015 447; sh. edhe Eubel V 344: “Promovetur iuxta decr. S. Congr. Prop., c. disp. ... prof. fidei, c. disp. ... gradus (AC 27 f. 188’); nat. in oppido Curbini dioec. Dyrrachien., aet. 40 an. pbr. (e bulla prov. S. Br. 2542 f. 400 ss.); depot. admin. Pulaten. 23 Dec. 1720 (S. Br. 2503 f. 7 s.; cf. Pulaten.); tr. ad. Alexien. 15 Nov. 1728”) Mungesa e emrit të Ndreut në regjistrat e këtij kolegji ka të bëjë pas gjase me faktin, se ai kreu në Fermo fazën përgatitore (gramatikë). Regjistrimi në kolegji si nxënës i rregullt bëhej pikërisht kur supozohej të ishte mbyllur me sukses kjo fazë.

18 Eubel V 347: “Promovetur iuxta decr. S. Congr. Prop., c. disp. ... gradus c. ind. ... cens. ep. et 2 dign., c. decr. ... prof. fidei ante cens. (AC 23 f. 193’); bulla prov. (S. Br. 1779 f. 285 ss.); nat. in loco Curbini dioec. Dyrrachien., aet 30 an. circ., pbr., missionarius post. dioec. Dyrrachien. (P. Dat. 1686 f. 101 ss.); decr. S. Congr. Prop. 26 Nov. 1685 et a S.S. 3 Apr. 1686 approbatum (l. c.). 11 Febr. 1690 Marinus Drago, ep. Catharen., depot. admin. Scutaren. de praesenti vacantis, donec illi de proprio pastore provusum fuerit, iuxta decr. S. Congr. Prop. 23 Ian. 1690 emanatum et a S. S. 26 Ian. approbatum (S. Br. 1799 f. 15).” Farlati & Coleti VII 331v.

11. <Marco \Massarecchius/ Massarecchi> (= shq. /Mark Mazreku/): "[...] nga Shkodra [?: Dioqeza e Shkupit – B.D.]¹⁹, lindur prej prindërish katolikë, hyri në kolegji më 15 janar 1673 në moshën 13 vjeç. Di gjuhën shqipe, pak ilirisht (= kroatisht/sllavisht) e turqisht dhe filloi të mësonte [në kolegji] parimet e gramatikës. Betimin e bëri pasi përfundoi kursin e filozofisë me pak ose aspak përfitim. Meqë nuk ishte i prerë as për të mësuar, as për shpirtmirësi, kërkoi vetë të largohej nga kolegji, çka iu pranua me shënimin për [... e palex. – B.D.] harxhet e rrugës dhe veshjen. Ishte rob Zoti i prerë së prapthi; u nis për në atdhe më ... [bosh – B.D.] tetor 1681." (RNCAPF I 126)
12. <Diodato Stampaneo>: "[...] bir i <Paolo Stampaneo> dhe <Maria de Nigris> nga qyteti i Lezhës. Hyri në kolegji më 27 tetor 1681, pasi kishte vizituar për katër vjet e gjysmë Kolegjin e Fermos, ku pas [studimit të] gramatikës kishte filluar me traktatin moral të Sakramenteve. Ka mbushur moshën 18 vjeç. Di gjuhën shqipe, italishten dhe latinishten. Bëri betimin më dt. 30 gusht 1682. Më 19 shtator 1683, u largua nga kolegji për të shkuar në Venecia pranë të ungjit, abatit Stampaneo. Ka studiuar [në kolegji – B.D.] dy vjet filozofi, por duke qenë i kërcënuar prej sëmundjes së veremit e duke pasur të dëmtuar edhe një venë në mushkëri u lirua [...] duke qenë i dobët për të udhëtuar në tjetër vend. Është një i ri me sjellje të mira, dhe i zgjuar; ka aftësi të mëdha në predikim, e në rast se Zoti i dhuron jetë, mund të shpresohet se do të bëhet një misionar i zoti dhe i zellshëm." (RNCAPF I 155)²⁰
13. <Giorgio Bogdani> (= shq. /Gjergj Bogdani/): "[...] bir i Mark Bogdanit dhe i Ana B[ogdanit], prindër katolikë të ritit latin, lindur në Shkup, në Serbi; për të u përkujdes vetë Pjetër Bogdani, axha i vet dhe arqipeshkëv i qytetit të përmendur, e me rekomandimin e tij pajiset me katër urdhrat minorë prej Kard. Barbarizo-s, ipeshkëv i Padova-s. Hyri në kolegji më 7 qershor 1697 në moshën 23 vjeç e tetë muaj, prej së cilës 11 [vjet] i kishte kaluar në Seminarin e Padovës. Bëri betimin më 15 gusht 1697. Por meqë ishte i kërcënuar prej veremit u dërgua

19 Në regjistër jepet pas gjase gabim vendlindja <da Scutari>. Për këtë konstatim na ndihmon libri i betimeve, ku lexojmë edhe betimin e shkruar latinisht dhe firmosur prej Mark Mazrekut dora vetë: "Ego Marcus Massarechius filius q. Petri Massarechij Diæc. Scopiensis plena habens Instituti huius Collegij [...]" (Giur. I 61 [53])

20 Për qëndrimin e tij në Fermo shih hollësisht Demiraj 2015 440, ku jepet edhe shënimi që vdiq i sëmurë gjatë rrugës në Padova. "22. <Diodato Stampaneo>† nga Lezha: e pruri vetë abati Stampaneo, i ungji, më dt. 9.5.1677; shkoi me të edhe në Kolegjin Urban më dt. 22.10.1681. Në Romë mori sëmundjen e tuberkulozit dhe vdiq tre vjet më pas, kur mbërriti në Padova."

për në vendlindje më 6 shtator të të njëjtit vit (1697), duke e pajisur me 30 skuda për harxhet e rrugës, 15 syresh për veshjet dhe 5 për punë devocioni. I ri me prirje optimale në punë letrash; i aftë për t'u bërë një punëtor i zellshëm në përhapjen e Ungjillit. Zoti e ka në dorë, nëse i ecën shëndeti.”²¹

14. <Andrea> (= shq. /Ndreu/): “[...] bir i Gjergjit dhe i Maries me prindër katolikë në Prizren të Shqipërisë \Serbisë/; hyri në kolegji më 24 maj 1700 në moshën 16 vjeç. Di gjuhën shqipe, sllave dhe turke. Bëri betimin më 7 shkurt 1702, me opsionin e mostumirjes për arsye shëndeti si edhe aftësish të paka në punë letrash. U lirua nga kolegji më 1 korrik 1704 meqë iu hakërrua mjeshtrit të vet në shkollën publike, por edhe se ishte gjithherë i pashpresë me përfituar diçka në punë studimi.” (RNCAPF I 212)²²
15. <Gio[uanni] Campsi> (= shq. /Gjon Kamps/): Një përkthim i kujdesshëm i skedës së Gjonit në regjistrin e përgjithshëm të kolegjit (RNCAPF I 247) ishte thujtë i pamundur për shkak të dëmtimeve vise-vise të tekstit. Gjithsesi mund të përmbledhim thujtët e me siguri që Gjoni ishte regjistruar në kolegji si i shkodran, bir i Markut – fillimisht katolik e më pas apokat (laraman) – dhe i Katerinës. Kishte mbushur ndërkohë 21 vjeç, kur hyri në kolegji me bursën Vives më dt. 27 tetor 1711, pasi kishte studiuar më parë plot 7 vjet në Kolegjin Ilirik të Fermo-s dhe aty kishte bërë edhe betimin.²³ Pasi kaloi një fazë të shkurtër përgatitore me ushtrime spirituale, u mor në provim, duke u klasifikuar menjëherë për të frekuentuar kursin e lartë të studimeve teologjike. Pas përfundimit me sukses të studimeve u shugurua prift, duke ngadhënjyer edhe laurean e doktorit në teologji dhe filozofi. Ndenji do kohë më gjatë në kolegji për arsye të rreziqeve që e kërcënonin në vendlindje. U largua për në dioqezën amë më dt. 22 korrik 1716.
16. <Antonio Albanese> (= shq. /Ndue Albanez/ ?): Këtë emër me mbiemër paksa të pazakonshëm për kohën në shqyrtim, nuk e ndeshim si të tillë në regjistrin themelor të Kolegjit Urban (RNCAPF I/ II), por rezulton në regjistrat vjetorë (vitet 1728-1731), të depozituar

21 Hyri në kolegji me bursën Vives. Në Libro dei Giuramenti (I 193-4 [185-6]) lexojmë edhe betimin e shkruar dhe nënshkruar prej tij: “Anno Domini 1697. Die i5 Augusti. | Ego Georgius Bogdani, filius Marci Bogdani, Diæcesis Scuporum in Regno Serviaë [...]”

22 Nuk kemi mundur të mësojmë më shumë lidhur me mbiemrin e familjes apo fisit të Ndreut, përkatësisht të Gjergjit, atit të tij.

23 Emrin e Gjonit e hasim në regjistrat e këtij kolegji, khs. Demiraj 2015 443: “Nr. 46 <Giovanni Camsi> (= shq. /Gjon Kamsi/) nga Shkodra: hyri në kolegji më dt. 7.7.1704, duke u transferuar më pas (më 21.10.1711) në Romë në Kolegjin Urban.”

në aktet e ASPF²⁴ si nxënës i këtij kolegji e me origjinë nga Shkodra; që ka hyrë në kolegji më dt. 5 shtator 1718 me bursën Albani [= Papa Clemens XI – B.D.]²⁵ Më shumë nuk mësojmë gjë për këtë nxënës. Do detaje forcojnë mëdyshjen se mos kemi të bëjmë me të njëjtin Ndue, të cilin e kemi regjistruar veças më poshtë, meqë shmangiet e të dhënave biografike janë të dukshme.

17. <Antonio di Michele> (= shq. /Ndue Mëhilli/ ~ /N. Mikeli/ ?): “Ndoi, bir prindërisht katolikë, rreth të 16-ve, lindur në Shkodër në Shqipëri. Më 18 maj 1725 u dekretua në Kongregacion pranimi i tij në kolegji, ku kishte hyrë [ndërkohë], por depozita [= bursa – B.D.] e tij ishte deri ditën e 19 majit; duke qenë i shoqëruar në këto anë prej klerikut Frà[te – (?)] Luca, priftit prefekt të misioneve në Shqipëri. Di gjuhën shqipe. U dërgua në kurset e gramatikës dhe dëshmoi të ishte i talentuar [... – e palex.], por i mefshtë. U vesh [me tunikën e nxënësit – B.D.] më 3 qershor 1725; më dt. 20 nëntor 1726 bëri betimin [----- e prish./e palex. – B.D.]²⁶ Më dt. 16 maj 1731 u largua nga kolegji për në Zarë, duke e pasë rekomanduar Kongregacioni i Shenjtë tek ipeshkvi²⁷ dhe u dërgua me urdhër të mjekëve në atë qytet, për shkak të një sëmundjeje [... – e palex. – B.D.] që i kishte rënë thuajse qysh prej një viti. Iu dhanë për veshje, [shërbime] devocioni dhe ushqim 35 skuda; dhe në qytetin e përmendur të Zarës vdiq prej sëmundjes së keqe.” (RNCAPF I 288 – sh. edhe më lart, nr. 16)
18. <Antonio Logorezzi> (= shq. /Ndue Logoreci/: Përpos regjistrimit të emrit si shqiptar (: <albanese>) nuk kemi tjetër detaj të shkruar në regjistrin e përgjithshëm të Kolegjit Urban (RNCAPF I 314). Edhe kërkimet tona në ASPF nuk patën sukses. Po të marrim parasysh vitet e hyrjeve në regjistër para dhe pas këtij emri, lejohej të fiksojmë me afërsi kohën e regjistrimit pas vitit 1733.
19. <Giuseppe Lumbesci> (= shq. /Zef Lumbeshi/): në regjistrin e përgjithshëm lexojmë të regjistruar vetëm në shtojcë emrin e këtij rishtari, gjithsesi i paplotësuar me informacion të mëtejshëm. (RNCAPF I 438) Burime të tjera në ASPF kumtojnë që një nxënës

24 ASPF CP Coll. Urbano vol. 5: a) Catalogus Alumnorum Ven. Coll. Urbani de Prop. Fide. Pro Anno MDCCXXVIII, fol. 52r; b) Catal... Anno MDCCXXIX fol 161r; c) Catal... Anno MDCCXXX fol. 361r, 363r; dhe d) Catal... MDCCXXXI fol. 398r.

25 Shtojmë gjithashtu që në regjistrat e cituar në shënimin e mësipërm ndeshim edhe shmangie, sa i përket hyrjes a) në kolegji më <5. 8bre 1718> (viti 1728) dhe <15. 9bre 1722> (viti 1729) dhe b) bursës <Albani> (viti 1728) dhe <Sconnegate> (viti 1729).

26 Pjesa që vijon është shtuar nga një dorë tjetër, pas gjase më vonë.

27 Ipeshkëvi i Zarës këtë periudhë ishte Imz. Vincenzo Zmajević, ideatori dhe organizatori i Kuvendit të Arbënit. (Mërqinje, janar 1703 – sh. Bartl 1975 9vv.).

(12-vjeçar nga Kratova?) me këtë emër u përzgjedh nga Gjon P. Nikollë Kazazi gjatë vizitës së tij apostolike në Bullgari në vitin 1742, por u dërgua më parë në Kolegjin Ilirik të Feros, ku qëndroi deri në fillim të vitit 1746, kur u transferua në Kolegjin Urban.²⁸ Pas mbarimit të studimeve Zefi është kthyer në vendlindje, ku u mësonte doktrinën shqip carrokové katolike në shkollën e Gjakovës, përkatësisht në selinë arqipeshkvore të Gjon P. Nikollë Kazazit. I qëndroi gjithherë pranë Kazait, madje asistoi edhe çastet e fundit, kur Mjeshtri i Madh i letrave shqip mbylli sytë për të fundit herë më 5 gusht 1752.²⁹

20. <Angelo Logorezzi> (= shq. /Engjëll Logoreci/): Ndër ato të dhëna kryesore që kumton regjistri i përgjithshëm (RNCAPF I 341), mësojmë se Ndreu është rishtar i shkodran i ritit latin e që kishte hyrë në kolegji më 15 mars 1744 me bursën Albani. Në vitin e tretë të studimeve (1747), në moshën 17 vjeç, studionte retorikë, ndërsa në vitin e gjashtë (1750) ndiqte kursin e dytë të filozofisë. Betimin e bëri më 1 shkurt 1748, nga ku mësojmë edhe ndonjë detaj biografik shtesë: “Ego Angelus Logoretius filius Marci, Diæcesis Scodraë ... etc.” (Giur. II, 487-8 [271-2])³⁰
21. <Giuseppe Nicholouich> (= shq. /Zef Nikolla/): Ndër të dhënat bazë që kumton regjistri i përgjithshëm (RNCAPF I 341), mësojmë se është nxënës gjakovar i ritit latin e që kishte hyrë në kolegji më 19 mars 1744 me bursën Adda. Në regjistrin e vitit 1747 rezulton të ketë mbushur moshën 19 vjeç dhe studion filozofi në vitin e parë, ndërsa në atë të vitit 1749 si 21-vjeçar që studion në vitin e parë të kursit të teologjisë. Nga të tjera burime dimë që formimin fillestar e ka marrë në Gjakovë prej Gjon P. Nikollë Kazazit, arqipeshkëv i Shkupit – pas gjase, axha i vet –, i cili e shoqëron për t’u regjistruar në kolegji në Romë personalisht me rastin e vizitës së tij *ad limina* në Kurinë e Shenjtë.³¹
22. <Giuseppe Beriscia> (= shq. /Zef Berisha/): Përpos regjistrimit të emrit nuk hasim tjetër detaj në regjistrin e përgjithshëm të Kolegjit Urban. (RNCAPF I 347) Burime të tjera arkivore na lejojnë ta identifikojmë me të njëjtin person të regjistruar më parë në Kolegjin Ilirik të Feros <Giuseppe Beriscia (de Niccolouich)>, por që u transferua në Kolegjin

28 Demiraj 2015 437, sidomos 445: “76. <Giuseppe Lumbesci> (= shq. Zef Lumbeshi) nga <Sunfi> (= shq. Zymi ?) në Dioqezën e Shkupit: hyri në kolegji më dt. 7.8.1740 dhe u transferua në vitin 1746 në Kolegjin Urban në Romë.”

29 Demiraj 2012 97vv.

30 Emrin e Engjëll Logorecit me të dhënat bazë, të përmendura më lart e kemi ndeshur në tre regjistra vjetorë të kolegjit, që ndodhen në ACU dhe ASPF: CAVCU 1747, CAVCU 1749, CAVCU 1750.

31 Demiraj 2013 298.

Urban në fillim të vitit 1746, pas mbylljes së atij kolegji.³²

23. <Matteo Massarek> (= shq. /Mati Mazreku/): Edhe Matia është një ish-nxënës i Gjon P. Nikollë Kazazit, me origjinë nga Janjeva që u transferua në kolegji më 2 mars 1746 me bursën e Kongregacionit të Shenjtë, pas mbylljes së Kolegjit Ilirik të Fermos.³³ Në vitin 1747 e ndeshim të regjistruar në kursin e filozofisë (viti I: CAVCV 1747) e pas dy vjetësh, në moshën 22 vjeç, në kursin e teologjisë (viti I: CAVCV 1749). Hollësi të mëtejshme lidhur me karrierën e tij kishtare i mësojmë te Eubel VI 370, meqë më dt. 18 dhjetor 1758, në moshën 33 vjeç, ngjitet në katedrën e mjeshtrit të tij të dikurshëm si arqipeshkëv i Shkupit, të cilën e mban për 54 vjet me radhë.³⁴
24. <Antonio Lumbesci> (= shq. /Ndue Lumbeshi/): regjistri i përgjithshëm (RNCAPF I 349) kumton të dhënat bazë, të nxjerra nga katalogët e viteve shkollore 1747 dhe 1750 (në ACU dhe ASPF), si edhe ndonjë copëz të kopjuar prej librit të betimeve, ku mësojmë të jetë betuar më 1 shkurt të vitit 1748: “Anno Domini 1748: Die prima Februarij = Ego Antonius Lumbesci filius Nicolai, Diecesis Jacouensis ... etc.” (Giur. I 261/2) Ndoi – edhe ky një nxënës i Gjon Nikollë Kazazit³⁵ – hyri në kolegji më 2 mars 1746, pra të njëjtën ditë me Mati Mazrekun (sh. nr. 23), meqë edhe ky vinte nga Kolegji i Fermos.³⁶ Gjithsesi, duke qenë më çunak në moshë, i duhej të mësonte shumë gjëra nga e para. Prashtu, në regjistrin e vitit 1747 lexojmë të ketë hyrë në kolegji me bursë të Kongregacionit të Shenjtë, të ketë mbushur atë vit moshën 16

32 Demiraj 2013 27, 98, 10, 102 etj.; sidomos Demiraj 2015 445: “78. <Giuseppe Beriscia> (= shq. Zef Berisha) nga Gjakova në Dioqezën e Shkupit: hyri në kolegji më 18.9.1740 e kaloi më pas në vitin 1746 në Romë në Kolegjin Urban.”

33 Demiraj 2015 437; sidomos 445: “77. <Matteo Masarek> (= shq. Mati Mazreku) nga Janjeva në Dioqezën e Shkupit: hyri në kolegji më dt. 18.9.1740 dhe u transferua më pas (13.3.1744) në Kolegjin Urban në Romë.”

34 Eubel VI 370: „Promovetur c. disp. ... gradus, c. ind. ... cens. ep. et 2 pbr, c. derr. ... prof. fidei (AC 35 f. 172) iuxta decr. S. Congr. Prop. 18 Sept. 1758 emanatum et a S.S. 1 Oct. approbatum (P. Dat. 135 f. 90 ss.); conc. Pallium 12 Febr. 1759 (AC 35 f. 190); bulla prov. (S. Br. 3658 f. 1 ss.); nat. in dioec. Scopian. aet. 32 an. circ., pbr, olim alumnus coll. Urbani de Prop. Fide, vic. gen. Scopian. (P. Dat. 135 f. 90 ss.); ob. a. 1812 (Gams 417).“ Sh. edhe Farlati & Coleti VIII 22v.

35 Vërejmë këtë periudhë një fluks të rishtarëve shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Fermos dhe atij Urban në Romë (nr. 19-34), të cilin kemi të drejtë ta bashkëlidhim me efektin pozitiv që përcolli memorandumi i Gjon P. Nikollë Kazazit drejtuar Papa Benediktit XIV në vitin 1743, përkatësisht përgjigjes së menjëhershme të Papës me letrën e tij enciklike *Inter omnigenas* më 2 shkurt 1744. Hollësisht Demiraj 2016e 92vv.

36 Demiraj 2015 437; sidomos 445: “81. <Antonio Lumbesci> (= shq. Ndue Lumbeshi) nga Dioqeza e Shkupit, i ardhur prej Kolegjit të Loretos më dt. 29.5.1744 dhe u transferua në Kolegjin Urban në vitin 1746.”

vjeç dhe se studion ndërkohë retorikë (CAVCU 1747), ndërsa në vitin 1750 fillon me vitin e parë të kursit të filozofisë.

25. <Giouanni Logoretzi> (= shq. /Gjon Logoreci/): Në regjistrin e përgjithshëm (RNCAPF I 349) mësojmë të dhënat kryesore, të fiksuara në regjistrat vjetorë për vitet shkollore 1747 dhe 1749, ndër të tjera: Gjoni është nxënës i ritit latin, nga Bria në Shqipëri dhe se është pranuar në kolegji më dy mars 1746, kur ishte 19 vjeç. Në vitin akademik 1747 studion në kursin e dytë të filozofisë (CAVCU 1747) dhe në kursin e parë të teologjisë (CAVCU 1749). Edhe Gjoni studionte më parë në Kolegjin Ilirik të Fermos, andaj iu desh t'i bashkohej grupit që u transferua në Romë pas mbylljes së atij kolegji.³⁷ Të dhëna biografike shtesë mësojmë te Eubel VI 349, i cili kumton për karrierën e tij kishtarë fillimisht si misionar apostolik e famullitar në Dioqezën e Shkupit dhe më pas vikar i përgjithshëm i asaj dioqeze, deri sa ngjit katedrën e ipeshkvit në Dioqezën së Pultit (2 prill 1781), ku zëvendëson komilitonin e dikurshëm në kolegji, Sandër Bardhin. (nr. 27)³⁸ Dhjetë vjet më vonë (më 26 shtator 1791) transferohet në Sapë po në funksionin e ipeshkvit të asaj dioqeze, ku mbyll sytë për të fundit herë më 1795.³⁹
26. <Giorgio Junchi> (= shq. /Gjergj Junki/): me të dhëna kryesore, të nxjerra prej tre regjistrave vjetorë (CAVCU 1747, CAVCU 1749 dhe CAVCU 1750 – në ACU dhe ASPF), si rishtar i ritit latin nga <Liuari in Albania> (= shq. Livari/Mal i Zi): “[...] i pranuar në kolegji më 2 mars 1746 me bursë të Kongregacionit të Shenjtë e se në vitin shkollor 1747 ka mbushur moshën 21 vjeç dhe studion në kursin e parë të filozofisë, ndërsa në vitet 1749 dhe 1750 në kursin e parë dhe të dytë të teologjisë.” (RNCAPF I 349). Është nxënësi më i ri shqiptar i Kolegjit Ilirik të Fermos, që iu bashkua grupit gjatë transferimit për në Romë, meqë u mbyll ai kolegji. (Demiraj 437)⁴⁰

37 Demiraj 2015 437; sidomos 445: “79. <Giovanni Logorezzi> (= shq. Gjon Logoreci) nga <Bria> në Dioqezën e Shkodrës: hyri në kolegji më dt. 7.4.1742 e kaloi më pas në vitin 1746 në Romë në Kolegjin Urban.”

38 Eubel VI 349 „Promovetur c. disp. ... gradus, c. decr. ... prof. fidei (AC 39 f. 150') iuxta decr. S. Congr. Prop. 29 Jan. 1781 emanatum et a S.S. 4 Febr. approbatum (P. Dat. 157 f. 31); bulla prov. (S. Br. 4373 f. 261 ss.), nat. in dioec. Scutaren. a. 1727, pbr., olim alumnus coll. Urbani de Prop. Fide. missionarius apost. et parrochus in dioec. Scopien., ab a. 1763 vic. gen. Scopien. (P. Dat. 157 f. 29 ss.); tr. ad Sappaten. 26 Sept. 1791.” Sh. edhe Farlati & Coleti VII 269.

39 Eubel VI 367: „Absolv. a vinc. Pulaten., tr. c. decr. ... prof fidei et iuram. fidel. (AC 40 f. 263'), iuxta decr. S. Congr. Prop. 19 Aug. 1791 emanatum et a S.S. 11 Sept. approbatum (P. Dat. 164 f. 230); bulla prov. (S. Br. 4388 f. 111 ss.), ob. a. 1795 (P. Dat. 169 f. 184).” Sh. edhe Farlati & Coleti VII 291.

40 Hollësisht Demiraj 2015 445: “82. <Giorgio Junchi> nga Livari në Dioqezën e Tivarit:

27. <Alessandro Bianchi \o Bianchi/> (= shq. /Sandër Bardhi/ ~ /Llesh B./ ?): në regjistrin e përgjithshëm (RNCAPF I 352) lexojmë të dhënat kryesore, të nxjerra prej regjistrave vjetorë CAVCU 1747 dhe 1756, si edhe prej librit të betimeve, ndër to: “[...] rishtar i ritit latin prej [Dioqezës së] Lezhës, që u pranua në kolegji me bursë të Kongregacionit të Shenjtë më dt. 16 qershor 1747, kur filloi me kurset e gramatikës dhe se në 1756, në vitin e fundit studimor ndiqte rregullisht kursin e dytë teologjisë.” Në librin e betimeve mësojmë përpos datës së betimit edhe atësinë e tij: “Anno Domini 1751. die 26. Maij | Ego Alexander Bianchi, filius Demetrii Diecesis Alexiensis ... etc.” (Giur. II 316). Ndër katalogët e tjerë vjetorë që kemi mundur të shfletojmë janë CAVCU 1749 dhe CAVCU 1750, kur Sandri ynë studionte ende me përkushtim në kurset e gramatikës. Për të mësojmë të ketë ngjitur shpejt shkallët e karrierës klerikale, duke u ulur në moshën 33 vjeç në katedrën e Dioqezës së Pultit (më 27 janar 1766), ku zëvendësohet më vonë prej komilitonit të vet Gjon Logorecit (nr. 22: 2 prill 1781), pasi ndërroi jetë pas 14 vjetësh në detyrë, më 1780.⁴¹
28. <Giorgio Radovani> (= shq. /Gjergj Radovani/): në regjistrin e përgjithshëm lexojmë të dhënat kryesore, ndër to: “Gjergj Radovani nga [Dioqeza e] Shkodrës në Shqipëri; i ritit latin; me bursën Adda; hyri në kolegji më 16. qershor 1747 në moshën 14 vjeç; del [emri i tij] në katalogët [e kolegjit] që ka studiuar të gjithë retorikën dhe në librin e dytë të betimeve, f. 302, lexohet: “Anno Domini 1749. die 21 Novembris | Ego Georgius Radovani, Filius Joannis Angeli. Diocesis Scodrensis ... etc.”, nga ku mësojmë që më datë 21 nëntor 1749, bëri betimet e zakonshme ditën e përmendur.” (RNCAPF I 449; CAVCU 1747). Hollësi të mëtejshme për karrierën e tij kishtare deri në funksionin e ipeshkvit të Shkodrës (1771-1787) dhe të arqipeshkvit të Tivarit (1787-1790) si edhe për vendin e tij në kulturën e shkrimit shqip shih Demiraj 2017b.
29. <Michele Pelescia> (= shq. /Mëhill Peleshja/ ~ /Mikel P./): në regjistrin e përgjithshëm (RNCAPF I 352) lexojmë të dhënat kryesore, të nxjerra prej katalogut vjetor CAVCU 1747, si edhe prej librit të betimeve, ndër to si: rishtar i ritit latin prej [Dioqezës së] Sapës, që pranohet në kolegji me bursë të Kongregacionit të Shenjtë të vitit 1747. Sikurse komilitoni

hyri në kolegji më 11.12.1745 dhe u transferua në vitin 1746 në Kolegjin Urban në Romë.”

- 41 Eubel VI 349: „Promovetur c. disp. ... gradus (AC 36 f. 135) iuxta decr. S. Congr. Prop. 17 Dec. 1765 emanatum et a S.S. 29 Dec. approbatum (P. Dat. 143 f. 25 ss.) ; bulla prov. (S. Br. 3665 f. 11 ss.) ; nat. in dioec. Alexien., aet. 33 an. circ., pbr., olim alumnus coll. Urbani de Prop. Fide, missionarius apost. et vic. capitularis Alexien. (P. Dat. 143 f. 25 ss.) ; ob. a. 1780 (Gams 413).” Sh. edhe Farlati & Coleti VII 276.

i vet Sandër Bardhi (nr. 27) fillon studimet më 16 qershor të atij viti në moshën 17 vjeç, duke ndjekur fillimisht të gjitha kurset e gramatikës. Në regjistër riprodhohet edhe fillimi i fjalisë së parë, të marrë prej librit të betimeve: “Anno D.ⁿⁱ 1749, die 21. Nouembris | Ego Michale Pelescia Filius Antoni Diecesis Sappatensis ... etc.” (Giur. II 291) Në ACU shfletuam krahas regjistrin vjetor CAVCU 1747 edhe gjegjësit e viteve 1749 dhe 1750, ku mësojmë se vijon të studiojë gramatikë. Më shumë se këto informacione nuk kemi mundur të qëmtojmë dot.

30. <Nicolo Deluchi de Scestani> (= shq. /Nikollë Deluq Shestani/): hyn në kolegji më dt. 20 korrik 1752, në moshë 15 vjeç me bursë të Kongregacionit të Shenjtë, ndërsa betimin lejohet ta bëjë dy vjet më vonë: “Anno Domini 1754. Die 14. Septembris | Ego Nicolaus De Luchi filius Petri Dioecesis Antibarensis ... etc.” (RNCAPF I 353) Nikollën e ndeshim edhe në regjistrin e vitit 1761 si nxënës 24-vjeçar që studion në kursin e parë të teologjisë. (ACU CAVCV 1761)
31. <Simone Dodmassei> (= shq. /Simon Dodmasi/): në regjistrin e përgjithshëm (RNCAPF I 354) përmbledhen thukët të dhënat e regjistrave vjetorë CAVCU 1749, 1750 dhe 1756, të cilët i kemi shfletuar veças në ACU dhe ASPF. Ndër të dhënat biografike mësojmë që Simoni ynë hyn në kolegji në moshën 16 vjeç me bursën Adda më 10 janar 1748 si rishtar i shkodran i ritit latin. Në vitin shkollor 1756 studionte ndërkohë në kursin e dytë të teologjisë që ishte zakonisht kursi përmbyllës i studimeve të rregullta në kolegji. E ndeshim edhe në librin e betimeve, ku shkruan e firmos, ndër të tjera: “Anno Domini 1751. die 26 Maii = Ego Simon Dodmassei filius Antonii, Diæcesis Scodrensis ... etc.” (Giur. II 309)
32. <Antonio Vladagni> (= shq. /Ndue Vlladanji/): në regjistrin e përgjithshëm (RNCAPF I 354) përmbledhen thukët të dhënat e regjistrin vjetor CAVCU 1750, në të cilin mësojmë se ka hyrë në kolegji me bursën Vives më dt. 28 tetor 1749 si rishtar i ritit latin në moshën 17 vjeç, i dërguar nga Dioqeza e Shkodrës e që ka filluar studimet me kurset themelore të gramatikës. Lexojmë po aty një pasazh të shkurtër nga libri i betimeve me të dhëna biografike shtesë: “Anno D[omi]ni 1751, die 26 Maii | Ego Antonius Vladagni filius Nicolai, Diæcesis Scodrensis ... etc. (Giur. II 305) Në ASPF ndodhet e depozituar edhe kërkesa për t’i hapur një vend me bursë në kolegji.⁴²

42 ASPF SOCG 361: Collego de Prop. Fide. – Alumni, fol. 4r dhe 6r: “[...] Antonio Vladagni humiliss.^{mo} ora di V.E. giouane di 18 anni, Albanese, sotto il dominio del Turco, prouetto nella grammatica, desideroso di auanzarsi nella disciplina, e pietà xpna, supplica la benignità dell’ E. V. a degnarsi di ammetterlo p[er] Alunno del Collegio di propaganda fide, che perpetuam.^{te} pregarà Dio p[er] la prospertà dell’ Em.^a V.ra.”, si edhe 5r: “[...]”

33. <Matteo Bosa Krasnich> (= shq. /Mati Boza Krasniqi/): në regjistrin e përgjithshëm lexojmë fillimisht (RNCAPF I 360) vetëm referencën e CAVCU 1750 si rishtar gjakovar i ritit latin, në moshën 12 vjeç, që ka hyrë në kolegji më dt. 20 janar 1750, pasi i është akorduar një vend me bursën Adda. Ka filluar të studiojë në kurset përgatitore të gramatikës.
- 33.1 <Matteo Bosa Jacova>: emër nxënësi në kolegji i patrajtuar në detaj në regjistrin e përgjithshëm (RNCAPF I 452: <Matteo Bosa>). Kemi të bëjmë pas gjase me të njëjtin rishtar: <Matteo Bosa (Krasnich)>, për të cilin shih nr. 33 dhe 33.2.
- 33.2 <Matteo Bosa>: një regjistrim pas gjase të tretë dhe të fundit të Matiut (nr. 33) pa llagapin /Krasniqi/ ose <Jacova> e lexojmë shtojcën e këtij regjistri (RNCAPF I 452: <Matteo Bosa>), që i referohet katalogut vjetor CAVCU 1756 (në ACU), kur ky ish-rishtar i Gjon P. Nikollë Kazazit⁴³ kishte filluar ndërkohë të studionte filozofi në kursin e dytë. Betimin e ka kryer më 20 shtator 1754, siç lexojmë edhe në librin e betimeve: “Anno Domini 1754. 20 Septembris = ... Matheus Bosa filius Petri Crasnich Dioecesis Jacouiensis ... etc.” (Giur. II 347-8)
34. <Tomaso Mariagni> (= shq. /Tomë Mariani/): regjistrohet të njëjtën ditë në kolegji me Mati Krasniqin (nr. 33), bash më 20 janar 1750 si rishtar i shkodran në moshën 14 vjeç, i ritit latin me bursë të Kongregacionit të Shenjtë e që ka nisur të studiojë kurset bazë të gramatikës. Betimin e kryen dy vjet më vonë, më 14 tetor 1752: “[...] Anno Domini MDCCLII. XIV die Octobris | Thomas Mariagni filius Georgii. Diæcesis Scodrensis ... etc.” (Giur. II 332) Nuk mësojmë më shumë në regjistër përpos shënimit nga një dorë e dytë: “Për këtë të ri nuk dalin shënime të tjera lidhur me prirjet dhe ecurinë e tij. Gjithsesi është shkruar mjaft mbi shkëlqimin e tij pranë Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s, duke qenë ndërkohë arqipeshkëv i Durrësit në [provincën kishtarë të] Maqedonisë.” (RNCAPF I 361). Detaje të mëtejshme biografike si edhe lidhur me karrierën e tij kishtarë në atdhe i mësojmë tek Eubel VI 203,⁴⁴ ndër të tjera: që ka

In co[n]formità di molte istanze fatte all' E.E.V.V. d' Antonio Vladagni Albanese cerca d'ottenere un luogo nell' collegio de propaganda fide oue in puochi anni hauerebbe finito li suoi studi , ma p[er] carestia di luochi no hauendo otener la gra[tia], et non potendo qui piu dimorare, et tutta l'humittà riccore alla paterna piettà dell' E.E.V.V. accio restassero seruute di souenirlo, et qualche poco di uiaticho, et che à pena si puotesse transferire alla patria et Deus &”

43 Demiraj 2006 103, 106, 116v.

44 Detajet e mëtejshme lidhur me karrierën e tij kishtarë në atdhe i mësojmë tek Eubel VI 203, ndër të tjera: “Promovetur c. disp. ... prof. fidei (AC 38 f. 39) iuxta decr. S. Congr. Prop. 16 Maii 1774 emanatum et a S.S. 5 Iun. approbatum (P. Dat. 151 f. 170); bulla prov. (S. Br. 3806 f. 123 ss.), conc. Pallium 27 Iun. 1774 (AC 38 f. 42); nat. in oppidio


lindur në Tophanë më 4 maj 1736 e që studimet në kolegji ka mbaruar duke marrë gradën “Doktor në Teologji”.

35. <Marino da \Montenegro/ ~~Negromonte~~ di Scopia nella Seruia> (= shq. /Marini i Crnagorës/ ~ /M. i Karadakut/?): nuk jemi në gjendje të përcaktojmë përkatësinë etnike të këtij rishtari të ritit latin që ka hyrë në kolegji të njëjtën ditë me Mati Krasniqin (Nr. 33, 33.1/2), shi më 20 janar 1750 me bursë të Kongregacionit të Shenjtë e që filloi të studiojë bashkë me të në kurset e gramatikës. (RNCAPF I 361 dhe CAVCU 1750)
- 35.1 <Marino Peretinouich Scopia in Seruia>: E ndeshim këtë emër të regjistruar në faqet shtojcë të RNCAPF I 453,⁴⁵ si edhe në regjistrin vjetor CAVCU 1756 (UCU + ASPF), kur studion filozofi në vitin e dytë me bursën Adda. Mungesa e të dhënave mbi periudhën e mëparshme, sikurse edhe data e hyrjes në kolegji më 20 janar 1750 e forcon dyshimin, se mos kemi të bëjmë në këtë rast me të njëjtin person: Marinin e Crnagorës që regjistruam më lart (nr. 35).
36. <Nicolò Bianchi> (= shq. /Nikollë Bardhi/): e ndeshim emrin e këtij rishtari në regjistrin e përgjithshëm (RNCAPF I 366), që i referohet katalogut vjetor CAVCU 1756) duke kumtuar këto të dhëna të përgjithshme: rishtar i ritit latin, prej Dioqezës së Lezhës; hyri në kolegji më dt. 16 nëntor 1751 me bursën Adda; është ndërkohë (1756) në moshën 22 vjeç dhe studion në kursin e retorikës. Në librin e betimeve mësojmë gjithashtu që është biri i Palit dhe ka bërë betimin më dt. 14 shtator 1754: “Anno Domini 1754. die 14 Septembris | Ego Nicolaus Bianchi filius Pauli, Diæcesis Alexiensis ... etc.” (Giur. II 349).
37. <Marco Musoni> (= shq. /Mark Muzoni/): Pak informacion kemi për këtë rishtar të ritit latin, të dërguar në kolegji prej Dioqezës së Shkodrës në moshën 12 vjeç, i cili filloi studimet në kurset themelore të gramatikës më 16 mars 1756 (RNCAPF I 381; CAVCU 1756). Gjësënd tjetër s’kemi mundur të qëmtojmë.

Tophanae dioec. Scutaren. 4 Maii 1736, alumnus fuit primum coll. Urbani de Prop. Fide, deinde coll. S. Familiae civ. Neapolitan., pbr., doct. theol. coll. Urbani 24 Maii 1774 (P. dat. 151 f. 168 ss.); 13 jan. 1795 deput. visit. apost. dioec. Alexien. et sappaten. (S. Br. 4269 f. 27 ss.)” Sh. edhe Farlati & Coleti VII 384.

- 45 Teksti i plotë i dorëshkrimit: “Marino Peretinouich (cat. 1756) di Scopia nella ~~Albania~~ Seruia = di età anni 20 = di Rito Latino = dell’Alunnato d’Adda = entro in Collegio li 20. Gennaro dell’Anno 1750 = studia il 2° anno di filosofia = E nel libro 2° dei Giuramenti pagina 343 si legge = an[no] D[omi]ni 1754. Die 14. Septemb. Marinus Peretinovich filius Nicolai Diæcesi Scopiensis = rilevasi della data 14. Settembre 1754 che in tal giorno presto li soliti giuramenti = E in fine di detto Giuramento si legge una breve notizia del Rettore di que. tempo cosi: De hoc nihil possum affirmare.”

38. <Giouanni Scurra> (= shq. /Gjon Skurra/): siç mësojmë në regjistrin e përgjithshëm (RNCAPF I 381), Gjoni i kishte rrënjët familjare në <Bissa> (= shq. ON /Biza/?) të Arqipeshkëvisë së Durrësit dhe u pranua në kolegji në moshën 14 vjeç, shi më 16 qershor 1747 me bursën Adda (CAVCU 1747). Në katalogun e vitit 1750 studionte ende në kurset e gramatikës (CAVCU 1750), ndërkohë që e kishte kryer betimin qysh më 21 nëntor 1749: “An. D.ⁿⁱ 1749. die 21 Nouemb. | Ego Joannes Filius Marci Scura Diaecesis Epidanni ... etc.” (Giur. II 397)
39. <Paolo Sogagni> (= shq. /Pal Zogaj/): ish-rishtar i Imz. Gjon P. Nikollë Kazazit me vendlindje /Soganjin/ (= sot *Zogaj*), dikur famulli që administrohej prej misionit të Gjakovës në Arqipeshkëvinë e Shkupit.⁴⁶ Pali hyri në kolegji më dt. 10 mars 1749 në moshën 16 vjeç e me bursën Spinola. Në katalogët e viteve 1749, 1750 dhe 1756 lexojmë të ketë studiuar përkatësisht në kurset e gramatikës e të filozofisë në vitin e dytë. Në librin e betimeve mësojmë gjithashtu atësinë e tij si biri i Jakut që bëri betimin më dt. 20 shtator 1752: “Anno Domini 1752. die 20 Septembris | Ego Paulus Sogagni filius Jacobi Dioecesis Scopiensis ... etc.” Nuk mungon në fund të zërit të tij në regjistrin e përgjithshëm edhe riprodhimi i shënimit të rektorit të asaj kohe: “Fu un giouine di ottimo talento, e buoni costumi e di questi dimostrò seminare di esser adorno.” (RNCAPF I 406; CAVCU 1749; CAVCU 1750; CAVCU 1756; Giur. II 327: <Paulus \Bria de/ Sogagni>).⁴⁷ Betimi i Palit është rasti i vetëm në këtë libër të kolegjit, kur një rishtar shqiptar nënshkruan në tekstin kanonik të betimit edhe me një fjali të shkurtër shqip, ku edhe insiston se është prej Zogajt:



“[...] Ego Paulus \Bria de/ Sogagni propria manu scripsi | E kam shkruar mbë kamb këtë bë: jam prej Soganji”

40. <Nicolo Malci> (= shq. /Nikollë Malçi/?): regjistri i përgjithshëm (RNCAPF I 385) i referohet vetëm librit të betimeve me fjalinë nistore: “Anno Domini 1764. 5. Nonas Majas [= 3 maj] | Ego Nicolaus Malci filius Ambrosii Diæcesis Dyrrachiensis ... etc.” (Giur. II 455), nga ku mësojmë vetëm se është biri i Ambrozit me vendbanim në Dioqezën e Durrësit. Gjithashtu tekstit i shtohet edhe shënimi i rektorit përkatës,

46 Demiraj ... Kazazi

47 Vajtja në Zarë sh. ... Zefi

që ndërkohë ushtron edhe funksionin e ipeshkvit në Dhe të Arbënit: “Hodie inter omnes albanos Episcopos eminet praeclarissime R.mus D. Nicolaus Malci.” Na jepet kështu mundësia të mësojmë më shumë për personin e tij në Eubel (VI 76), pasi regjistrohen ndër të tjera: mbarimi me sukses i studimeve në kolegji ku fiton edhe gradën e doktorit në filozofi dhe teologji; se para konsakrimit ipeshkvor ishte vikar i përgjithshëm i Arqipeshkëvisë së Durrësit; e më 24 korrik 1797 ngjiti katedrën e ipeshkvit të Dioqezës së Lezhës, kur ishte në moshën 51 vjeç; duke e ushtruar këtë funksion deri në gusht të vitit 1826, kur mbyll sytë të fundit herë.⁴⁸

41. <Pietro Milidita> ~ <Petrus Mierdita> (= shq. /Pjetër Mi(e)rdita/): erdhi në kolegji më dt. 18 prill 1758 prej Dioqezës së Lezhës si rishtar 16-vjeçar, i ritit latin, e në vitin shkollor 1760 studionte retorikë. Në betimin e kryer ditën e Shën Tomës (= <S. Tommaso>) më dt. 21 dhjetor 1760 gjendet edhe një shënim i shkurtër, si vijon: “Trà gli alunni albanesi merita nell’ applicazione ai studii d’esser annoverato trà i primi, nel talento era i[l] mediocr[o]: nei costumi a niuno era il secondo.”. Përndryshe kopjohet si zakonisht fillimi i tekstit “Anno Domini 1760. die 21. Decembris | Petrus Mierdita Filius Antonii Diæcesis Alexiensis ... etc.” (RNCAPF I 386; CAVCU 1761)
42. <Andrea Crasnich> (= shq. /Ndre Krasniqi/): në regjistrin e përgjithshëm ngjërojmë së pari referimin e bërë në katalogun vjetor të vitit 1761, i cili na kumton ndër të tjera: misionin dorëzanës të Gjakovës që dërgon rishtarin e vet të ritit latin në moshën 14 vjeç në kolegji me bursën Scan(n)agata dhe ditën e hyrjes së tij në kolegji më 14 shtator 1760, kur fillon me studimet në kurset bazë të gramatikës. Referimi i dytë i takon librit të betimeve, prej të cilit mësojmë edhe atësinë e Ndreut tonë, përpos datës së betimit më 3 maj 1764: “Anno 1764. die 3. Maij | Ego Andreas Crasnich filius Joannis Diæcesis Scopiensis ... etc.” (RNCAPF I 395; CAVCU 1761; Giut. II 454)
43. <Giuseppe Massarech> (= shq. /Zef Mazreku/): rishtar i ritit latin dhe komiliton i Ndre Krasniqit (nr. 42), nga Janjeva në Arqipeshkëvinë e Shkupit, që hyn në kolegji me bursën Spinola po në moshën 14 vjeç e po më 14 shtator 1760, duke nisur studimet po me kurset e gramatikës. Bëhet në regjistër gjithashtu referimi i zakonshëm i fjalisë së parë prej librit të betimeve: “An. D.ni 1764 5. Nonas. Maji [= 3 maj – B.D.]

48 “Promovetur c. ind. ... cons. ep. et 2 pbr., c. decr. ... prof. fidei (AC 41 f. 404) iuxta decr. S. Congr. Prop. 19 Iun. 1797 emanatum et a S.S. 25 Iun. approbatum (P. Dat. 169 f. 71); bulla prov. (S. Br. 4389 f. 53 ss.), nat. in dioec. Dyrrachien., aet. 51 circ. an., pbr. doct. phil. et theol. in coll. Urbano de Prop. Fide, vic. gen. Dyrrachien. (P. dat. 169 f. 69 ss.); ob. ante 28 Aug. 1826 (S. Br. 4757 n. 4).” Sh. edhe Farlati & Coleti VII 384.

Josephus Massarech Filius Andreae. Dioecesis Scopiensis ... etc...” në fund vjen edhe shënimi ngazëllyes i rektorit: “In omnibus excellens fuit.” (RNCAPF I 395; CAVCU 1761; Giur. II 453)

44. <Nicolo Melgusci \Melguscus/> (= shq. /Nikollë Melgushi/): rishtar i ritit latin që u dërgua në kolegji në moshën 18 vjeç prej dioqezës së Sapës me bursën Adda. Hyri në kolegji më dt. 17 korrik të vitit 1761, ku filloi të studioje në kursin e gramatikës. Vendlindjen (: Hajmeli) dhe atësinë e tij (: biri i Ndreut) i mësojmë në librin e betimeve, ku shkruan e firmos një vit më vonë, më dt. 5 gusht: “Anno 1762. die 5.^o Augusti | Ego Nicolaus Melguscus filius Andrea Melgusci Kaemelli [= Hajmeli] Dioecesis Sappatensis ... etc.”. Skeda e tij në regjistrin e përgjithshëm mbyllet me kumtin e dhimbshëm të rektorit përkatës: “Melgusci i sipërpërmendur vdiq si student në [rezidencën papnore në] Albano dhe u varros në katedralen e atij qyteti” (RNCAPF I 398; CAVCU 1761; Giur. II 430-1)
45. <Michele Criesesi> (= shq. /Mëhill Kryeziu/ ~ /Mikel K./ ?): hyn në kolegji më dt. 19 korrik 1761 në moshën 15 vjeç, duke fituar bursën Vives dhe filluar, siç pritej zakonisht, me kursin e gramatikës. Në tekstin e betimit, bërë më 3 maj 1764 mësojmë edhe atësinë e tij si biri i Palit prej dioqezës së Lezhës: “Anno Domini 1764. die 3 maji | Ego Michael filius Pauli Criesesi Dioecesis Alexiensis ... etc.”. Nuk mundon edhe shënimi i rektorit të dikurshëm në fund të zërit të tij në regjistrin e përgjithshëm: “Adolescenti uota sua Domino uouit, et in Patria exactissime reddit.” (RNCAPF I 399; CAVCU 1761; Giur. II 447)
46. <Pietro \Lumsci/ Lumpsi> (= shq. /Pjetër Lum(p)shi/): i ri 17 vjeçar që hyri në kolegji me bursën Adda më dt. 17 korrik 1761, duke filluar me kursin e gramatikës. Në tekstin e shkurtër të riprodhuar nga libri i betimeve mësojmë krahas ditës së tij të betimit më 20 maj 1764 edhe atësinë e tij bashkë me dioqezën amë të Sapës që e dërgoi në kolegji: “Anno Domini 1764. die 20 maji | Ego Petrus Lumsci Gregorji filius Diæcesi Sappatensis ... etc.” Në mbyllje edhe vlerësimi i rektorit të dikurshëm: “Optimis imbutus, ingenio mediokri &” (RNCAPF I 399; CAVCU 1761; Giur. II 451)
47. <Nicolò Canci> (= shq. /Nikollë Kançi/): rishtari shqiptar i radhës që hyn në vitin 1761 në kolegji, më 21 korrik të atij viti, kur fillon të studiojë gramatikë me bursën Vives. Betimin e bën më datë 29 janar 1767, siç rezultojnë nga regjistrimi i emrit të tij në librin e betimeve si biri i Pjetrit prej Dioqezës së Shkodrës: “Anno post Christum Natum 1767. die 29 januarii | Ego Nicolaus Canci filius Petri Diæcesi Scodrensis ... etc.” Vlerësimi i rektorit të asokohe rezultojnë: “Quod ingenio deerat,

bonis morbus, diligentia, et cura suppleuit Nic. Canci.” (RNCAPF I 400; CAVCU 1761; Giur. II 490)

48. <Gio[uanni] Batt[ist]a Messico>: zëri i tij në regjistrin e përgjithshëm i referohet vetëm librit të betimeve, ku mësojmë të jetë bir i Gjergjit prej Dioqezës së Durrësit, ose edhe të Krujës (në Arqipeshkëvinë e Durrësit), meqë firmos si i tillë në tekstin e betimit të bërë më dt. 29 janar 1767: “Joan. Bapt. Messico albanensis, e crojensis [...]”. Regjistrimi i tij përmbyllet me vlerësimin e rektorit të asaj kohe: “In omnibus bonis mediocris.” (RNCAPF I 402; Giur. II 462)
49. <Pietro Pezzi> (= shq. /Pjetër Peci/ ~ /P. Beci/ ?) = edhe për këtë rishtar ndeshim në regjistrin e përgjithshëm vetëm referencën e nxjerrë prej librit të betimeve, duke përcjellë kështu fjalinë nistore: “Anno Domini 1767. Die 29 Januari = Ego Petrus filius Alexandri Pezzi Diaecesis Antibarensis ... etc.”, nga ku mësojmë se Pjetri është dërguar në kolegji prej Dioqezës së Tivarit dhe se ka bërë betimin më dt. 29 janar 1767. Regjistrimi mbyllet me gjykimin e rektorit të atëhershëm: “Praeclare effecisset, nisi in patria praeueniret cum mora, et premium.” (RNCAPF I 408)
50. <Paolo Duoda> (= shq. /Pal Duoda/) = rishtar i shkodran, për të cilin në regjistrin e përgjithshëm jepet gjithashtu informacion për ditën e betimit në kolegji më 28 shkurt 1767: “Anno Domini 1767. die 28 Februarij | Ego Paulus Duoda filius Joannis Baptista Dioecesis Scodrensis ... etc.” (Giur. II 498) si edhe gjykimi i rektorit të dikurshëm: “Supradictus in Patria obdormivit in Domino, plenus meritis.” (RNCAPF I 422). Detaje të natyrës biografike e sidomos mbi aftësitë e rishtarit në fjalë i mësojmë prej referencës shoqëruese mbi pranimin në kolegji, të hartuar dikur prej Gjon P. Nikollë Kazazit, arqipeshkëv i Shkupit.⁴⁹
51. <Lazaro Logorezzi> (= shq. /Lazër Logoreci/): në regjistrin e përgjithshëm lexojmë të regjistruar vetëm emrin e këtij rishtari, të paplotësuar me informacion të mëtejshëm. (RNCAPF I 423)
52. <Nicolò Lindi> (= shq. /Nikollë Lindi/): e njëjta rrethanë e përshtuar më lart (nr. 51 – RNCAPF I 441). Këtë emër e kemi ndeshur dikur në listat e rishtarëve të Kolegjit të Fermos, ku ka studiuar disa vjet, veçse pa i përfunduar studimet e rregullta: “<Nicola Lindi> (= shq. /Nikollë Lindi/) nga Blinishti në Dioqezën e Sapës: kreu studimet në periudhën 19.6.1737 – 12.12.1743, duke u larguar si nëndiakon.” (Demiraj 2015 444). Të dhëna biografike shtesë për Nikollë Lindin fitojmë falë rrethanës që filloi të ushtrojë funksionin e ipeshkvit të

49 Shih Demiraj 2013 307vv. (Dok. nr. 17: SC Servia I, fol. 390)

Dioqezës së Sapës më 5 gusht 1765, në moshën 42 vjeç. Te Eubel (VI 367) mësojmë gjithashtu se lindi në Blinisht dhe se ndoqi me sukses studimet në Kolegjin Ilirik të Femos dhe në atë Urban të Propaganda Fide-s, e se ushtroi më pas funksionin e vikarit të përgjithshëm e të kapitarit të Dioqezës së Sapës, para se të konsakrohej ipeshkëv në atë Dioqezë. Vdiq në rezidencën e tij para dt. 19 gusht 1791.⁵⁰

Vëzhgim: Lista me emrat e rishtarëve që vijnë është nxjerrë me pak përjashtime prej vëllimit të dytë të regjistrit të përgjithshëm (RNCAPF II), që rrok një hapësirë kohore për thuajse një shekull (1760-1850). Regjistrimi është bërë në shumicën dërmuese të rasteve në latinisht, duke iu referuar kryesisht librit të betimeve, si edhe përshtypjeve të fituara nga rektori përkatës. Në pak raste përshkrimi është dygjuhësh latinisht dhe italisht, e rrallëherë vetëm italisht. Plotësime në regjistrim janë bërë aso rastesh, kur shkruesi i këtyre radhëve ka mundur të shfletojë fondet gjegjëse të regjistrave vjetorë ekzistues në ACU ose/edhe në ASPF.

53. <Joan[n]es Beriscia> (= shq. /Gjon Berisha/; biri i Zefit prej Dioqezës së Gjakovës, që bëri betimin më 25 nëntor 1769. Rektori përkatës shkruan gjithashtu: “Për aq sa më kujtohet, sjellja e tij ishte e lëvdueshme.” (RNCAPF II 4)
54. <Nicolo Trascia> (= /Nikollë Trasha/); përpos emrit dhe vitit (të hyrjes në kolegji) 1769 nuk mësojmë gjë tjetër për këtë rishtar. (RNCAPF II 6)
55. <Andreas Gasullori> (= shq. /Ndre Gazullori/ ~ /Gazulli/ ?); biri i Pjetrit prej Dioqezës së Sapës, që bëri betimin më 25 nëntor 1769. Rektori i atëhershëm shton në regjistër: “Ndërkohë është abat dhe meriton të përmendet me dinjitet për talentin e tij shembullor, bamirësinë në jetë e mënyrën e sjelljes, siç vepronte edhe në kolegji. [...] ka lënë të përkthyer gjithashtu ad litteram [material] nga gjuha turke në latinisht me dëshirën e vet si edhe me kërkesë të drejtuesve [të kolegjit].” (RNCAPF II 7)
56. <Lazarus Negri> (= shq. /Lazër Negri/ ~ /L. Ziu/?); biri i Jakut prej Dioqezës së Sapës, që bëri betimin më 21 shtator 1772. Sipas rektorit përkatës, ishte nxënës me zgjuars, aktivitet praktik, por me mënyrë sjelljeje që linte për të dëshiruar. (RNCAPF II 12)

50 “Promovetur c. disp. ... gradus, c. decr. ... prof. fidei (AC 36 f. 118’), iuxta decr. S. Congr. Prop. 17 Iun. 1765 emanatum et a S.S. 30 Iun. approbatum (P. Dat. 142 f. 85 ss.); bulla prov. (S. Br. 3664 f. 236 ss.) ; nat. in loco Blinishti dioec. Sappaten., aet. 42 an., pbr., alumnus coll. Firman. et Urbani de Prop. Fide, vic. gen. et capitularis Sappaten. (P. Dat. 142 f. 85 ss.) ; ob. in resid. ante 19 Aug. 1791 (P. Dat. 164 f. 239)” (Eubel VI 367) Sh. edhe Farlati & Coleti VII 291.

57. <Marcus Negri> (= shq. /Mark Negri/): biri i Pjetrit, prej Dioqezës së Sapës; bëri betimin në kalendën e 11-të të muajit tetor 1772. Rektori lë gjithashtu edhe shënimin, se Marku është e kundërta e të mëparshmit (nr. 56: /Lazër Negrit/): “[...] paqësor, i ditur, i kujdesshëm, andaj me meritë u përzgjedh pas disa vitesh ipeshkëv prej Kongregacionit të Shenjtë.” (RNCAPF II 15) Pikërisht ky kumt i fundit na lejon të fitojmë të dhëna biografike shtesë për të. Prashtu e ndeshim zërin e tij te Eubel (VI 349), ku lexojmë, ndër të tjera, se Marku ka lindur në Dioqezën e Sapës rreth vitit 1754, ka kryer studimet me sukses dhe doktoruar në teologji në Kolegjin Urban, duke u shuguruar prift më 12 mars 1780. Zhvilloi misionimin apostolik në dioqezën amë, derisa u ngjit në katedrën e ipeshkvit të Pultit më 26 shtator 1791 e më pas atë atë të Sapës më 8 korrik 1808. Vdiq më 13 maj 1820.⁵¹
58. <Jacobus Negri> (= shq. /Jak Negri/ ~ /Ziu/ ?): biri i Gjonit prej Dioqezës së Lezhës; bëri betimin në kalendën e 11-të të tetorit 1772. Sipas përshtypjes së fituar nga rektori i atëhershëm ishte një i ri me sjellje të mirë dhe prirje mesatare. (RNCAPF II 15)
59. <Joanes Camizzi> (= shq. /Gjon Kamici/ ?): biri i Markut prej Dioqezës së Durrësit ; bëri betimin në kalendën e 8-të të qershorit 1773. Më tej rektori shkruan: “Me pak fjalë dua të shprehem në raportin tim mbi Gjon Kamicin, se ai është i denjë me administruar ipeshkëvinë e vet si bari i parë. (RNCAPF II 20)
60. <Thomas Scura> (= shq. /Tomë Skurra/): biri i Grigorit prej Dioqezës së Durrësit, bëri betimin më dt. 17 prill 1774. Shënimi vazhdon me kumtin e dhimbshëm se ndërroi jetë, pasi ishte kthyer në vendlindje. (RNCAPF II 24) Mungesa e dokumentacionit nuk lejon të mësojmë nëse Toma kishte mundur të përfundonte studimet në kolegji.
61. <Petrus Nieci> (= shq. /Pjetër Nieçi/ ?): biri i Lazrit prej Dioqezës së Lezhës, i cili ka bërë betimin më dt. 26 dhejtor 1774. Më shumë se kaq rektori i dikurshëm e ka të vështirë të kumtojë se asgjë për mirë a për keq nuk i bie ndërmend lidhur me mbarëvajtjen e këtij nxënësi në kolegji: “Memoria fallit me de suprad.^o, ideoque cum nihil certi possem affirmare [...]” (RNCAPF II 27)
62. <Antonius Angelli Radovani> (= shq. /Ndue Engjëll Radovani/):

51 „Promovetur ad Pulaten. (AC 40 f. 264) iuxta decr. S. Congr. Prop. 19 Aug. 1791 emanatum et a S.S. 11 Sept. approbatum (P. Dat. 164 f. 205) ; bulla prov. (S. Br. 4383 f. 119 ss.) ; nat. in dioec. Sappaten., circ. a. 1754, prom. ad ord. pbr.^{tus} 12 Mart. 1780, doct. theol. coll. Urbani de Prop. Fide, curam animarum in dioec. Sappaten. exercuit (P. Dat. 164 f. 201 ss.) tr. ad Sappaten. 8 Iul 1808 (S. Br. 4555 f. 2’); ob. 13 Maii 1820 (S. Br. 4664 f. 8).” (Eubel VI 349) Sh. edhe Farlati & Coleti VII 269; 291.

biri i Gjergjit prej Dioqezës së Shkodrës; bëri betimin ditën e 8-të të kalendave të muajit shtator 1775. (RNCAPF II 32) Më shumë informacion fitojmë për të, falë funksionit të tij si ipeshkëv i Dioqezës së Sapës (më dt. 27 qershor 1796). Kështu mësojmë te Eubel (VI 347) që në kolegjin Urban ka mbaruar suksesshëm studimet duke fituar gradën e doktorit dhe duke u shuguruar prift. Konsakrimi si ipeshkëv i Sapës bëhet shpejt, në moshën 35 vjeç e pas nëntë vjetësh shërbimi si famullitar në Shkodër. Transferohet në Shkodër më dt. 8 korrik 1808 dhe gjen prehjen e fundit po aty gjashtë vjet më vonë, pra më 19 shtator 1814.⁵²

63. <Petrus Gasci> (= shq. /Pjetër Gashi/): biri i Gjonit, prej Dioqezës së Shkupit;⁵³ bëri betimin ditën e Ngjitjes së Shënmërisë në Qiell (15 gusht) 1777. Shkruesi sqaron se pas formulës së betimit është shkruar nga një dorë e dytë një kryq i madh si shenjë që ky nxënës nuk jetoi më gjatë në kolegji. (RNCAPF II 36)⁵⁴
64. <Mathias Toderi> (= shq. /Mati Todri/): biri i Ndoit prej Dioqezës së Lezhës; bëri betimin ditën e Ngjitjes së Shënmërisë në Qiell (15 gusht) 1778. Shkruesi shton së fundi që prej këtij rishtari pritej shumë, sikur të mos kishte ndërruar jetë para kohe në kolegji. (RNCAPF II 38)
65. <Dominicus Sacchi> (= shq. /Domenik Saçi/): biri i Pjetrit prej Dioqezës së Lezhës; bëri betimin në kremën e Epifanisë (6 janar) 1780. Nuk ishte i prerë për shkollë – shkruan dora e dytë në tekst –, andaj edhe u përzu për në vendlindje: „Stultus ut Luna mutatus est in fine Studiorum Sacra, ideoq. expulsus.“ (RNCAPF II 39)
66. <Paulus Gallata> (= shq. /Pal Gallata/): biri i Gjonit prej Dioqezës së Durrësit; bëri betimin ditën e kremte të Epifanisë (6 janar) 1780. Dora e dytë vazhdon me vlerësimin më të lartë të mundshëm: “Galata lulëzoi midis më të mirëve të tjerë të kësaj bashkësie (nacioni) në gjithçka: në sjellje, në talent, në disiplinë, dhe me aq sa dihet, është shembullor në angazhimin e tij kishtar [në dioqeën amë].“ (RNCAPF II 41)
67. <Josephus Colci> (= shq. /Zef Kolçi/): biri i Nikollës prej Dioqezës së

52 “Promovetur c. decr. ... vac. paroec. eccl. civ. Scutaren., prof. fidei (AC 41 f. 342), iuxta decr. S. Congr. Prop. 6 Iun. 1796 emanatum et a S.S. 12 Iun. approbatum (P. Dat. 169 f. 185); bulla prov. (S. Br. 4388 f. 132 ss.) ; nat. in dioec. Scutaren., aet. 35 an. circ., pbr., doct. theol. coll Urbani de Prop. Fide, a 9 annis parochus in civ. Scutaren. (P. Dat. 169 f. 183 ss.); tr. ad Scutaren. 8 Iul. 1808 (S. Br. 4555 f. 1 ss.); ob. ante 19 Sept. 1814 (P. Dat. 177 f. 280)” (Eubel VI 347) Sh. edhe Farlati & Coleti VII 291; 334.

53 Në tekst kemi të shkruar gabimisht “Diaecesis Seruiensis”.

54 “Hoc Crucis Signum repertum in fine inscriptionis \formulae iuramenti/ , alia manu factum indicat forsitan mortem Petri Gasci hic subscriptae ad distinationem, alius Petri Gasci, de quo suo Loco.” (Eubel VI po aty)

Shkodrës; bëri betimin në kremën e Ngjitjes së Shënmërisë në Qiell (15 gusht) 1781. Dora e dytë në skedë shton që ishte në fakt me aftësi mesatare, por gjithë kohës në kolegji dëshmoi sjellje të mirë, përkushtim dhe disiplinë. (RNCAPF II 43)

68. <Joannes Prodani> (= shq. /Gjon Prodani/): biri i Lorencit prej Dioqezës së Durrësit; bëri betimin në kremën e Epifanisë (6 janar) 1785. Vlerësimi është i lartë: shquhej midis rishtarësh shqiptarë, duke përmbushur me fjalë e vepra gjithçka kërkohej në kolegji; veçse s'pati fatin të jetojë gjatë. (RNCAPF II 56)
69. <Lazarus Battucci> (= shq. /Lazër Bytyçi/): biri Ndreut prej Dioqezës së Sapës; bëri betimin të njëjtën ditë me Gjon Prodanin (nr. 68: 6 janar 1785). Dora e dytë në përshkrim vijon, se me sa mban mend ky nxënës nuk ia thekte fare për shkollë, as përshëndetjet e urdhëruara në latinisht nuk i thosh dot, andaj i dhanë duart e u kthye mbrapsh nga erdhi. (RNCAPF II 57)
70. <Stephanus Negri \Pirata/⁵⁵> (= shq. /Shtjefën Negri/ ~ /Sh. Ziu/ ?): biri i Ndreut prej Dioqezës së Lezhës. Nxënës për së mbari shkruan dora e dytë në tekst. (RNCAPF II 58). Më shumë se kaq nuk mësojmë dot gjë për këtë nxënës.
71. <Nicolaus Murichi> (= shq. /Nikollë Muriqi/): biri i Gjon Lleshit prej (ish-Dioqezës së) Lisit; bëri betimin në kremën e Ngjitjes së Shënmërisë në Qiell (15 gusht) 1786. Ishte, sipas vlerësuesit (dora e dytë), më i miri ndër rishtarët shqiptarë, përkatësisht i denjë për t'u marrë si shembull për gjithë bashkatdhetarët e tij. (RNCAPF II 59)
72. <Petrus Crasnik> (= shq. /Pjetër Krasniqi/): biri i Markut prej Gjakove që bëri betimin të njëjtën ditë me Nikollë Muriqin (nr. 71: 15 gusht 1786). Nuk ndenji gjatë në kolegji, meqë e kishte marrë ndërkohë njërin ndër dy shenjat/urdhrat e meshtarisë. (RNCAPF II 60)
73. <Franciscus Abrasci> (= shq. /Frang Abrashi/): biri i Ndoit prej Dioqezës së Shkodrës, që bëri betimin të njëjtën ditë me dy të sipërhënuarit (më 15 gusht 1786). Nuk kemi ndonjë koment shtesë tek ky regjistrim. (RNCAPF II 62)
74. <Ambrosius Brucci> (= shq. /Ambroz Bruçi/): biri i Nikollës prej Dioqezës së Durrësit që bëri betimin në kremën e Ngjitjes së Shënmërisë në Qiell (15 gusht) 1789. Rishtar i nivelit mesatar në zgjuarësi e në të nxënë të mësimëve, por me vullnet të admirueshëm

55 Në emrin e nxënësit është shtuar duke u nënvizuar emri <Pirata> "Pirati" (?), i cili është i pazakonshëm si emër familjeje a fisi shqiptar. Ndoshta kemi të bëjmë me një nofkë ngjitur Shtjefnit në kolegji.

dhe mirësi në shpirt, shkruan dora e dytë në regjistër. (RNCAPF II 74)

75. <Jacobus Guracuchi> (= shq. /Jak Gurakuqi/ ~ /Jup G./?): biri i Mëhillit (~ Mikelit) prej Dioqezës së Shkodrës; bëri betimin në kremën e Ngjitjes së Shënmerisë në Qiell (15 gusht) 1791. U shqua në kolegji për thjeshtësinë, qetësinë, zellin e tij dhe për marrëdhëniet paqësore me gjithë komiltonët, sikurse për përnderimin dhe respektin ndaj tjetrit. (RNCAPF II 77)
76. <Antonius Beriscia> (= shq. /Ndue Berisha/): biri i Pjetrit prej (Dioqezës së) Gjakovës; bëri betimin të njëjtën ditë me Jak Gurakuqin (nr. 75: 15 gusht 1791). Nuk vijoi dot studimet deri në fund, se vdiq në kolegji. (RNCAPF II 77)
77. <Vincentius Battucci> (= shq. /Vinçec Bytyçi/): biri i Nikollës prej Dioqezës së Shkodrës që bëri betimin të njëjtën ditë me dy të sipërpërmendurit (më 15 gusht 1791). Ishte nxënës i nivelit mesatar, por me sjellje të mirë. (RNCAPF II 78)
78. <Petrus Borzi> (= shq. /Pjetër Borci/): biri i Nikollës prej Dioqezës së Shkodrës; bëri betimin më dt. 6 shtator 1791. U riatdhesua bashkë me nxënësit e tjerë në vitin 1798 (: me pushtimin francez) dhe ishte përgjegjës i grupit të atyre që u larguan prej portit të Ancona-s. Ishte i ri me sjellje të përkryera, i talentuar dhe shumë i impenjuar në studimin teologjik, që e ndoqi për thujtë dy vjet (RNCAPF II 81)
79. <Antonius Borzi> (= /Ndue Borci/): biri i Palit prej Dioqezës së Shkodrës; bëri betimin të njëjtën ditë me Pjetër Borcin (nr. 76: 6 shtator 1791). Kishte sjellje të mirë, karakter të fortë por jo aq i thjeshtë me pranuar ndonjë vërejtje që i bëhej. Iu desh edhe këtij të ndërpriste qëndrimin deri në fund, pas thujtë një viti e gjysmë studimi në kursin e teologjisë. (RNCAPF II 81)
80. <Andreas Negri> (= shq. /Ndre Negri/ ~ /N. Ziu/?): biri i Markut prej Dioqezës së Lezhës; bëri betimin më 15 gusht 1791. Ishte djalë i zoti. Studionte teologji, kur u desh të largohej një muaj pas komiltonëve të tjerë, d.m.th. më 2 gusht 1798. (RNCAPF II 82)
81. <Joannes Duca> (= shq. /Gjon Duka/): biri i Filipit prej Dioqezës së Sapës; bëri betimin më 15 gusht 1793. Nuk i përfundoi dot studimet (për shkak të hyrjes së trupave të Napoleonit). Ishte nxënës me sjellje të mira dhe zgjuarsis mesatare. (RNCAPF II 84)
82. <Joannes Gasci> (= shq. /Gjon Gashi/): biri i Markut prej Dioqezës së Shkupit, që bëri betimin më 15 gusht 1794. (RNCAPF II 85) Nuk shkruhet më tej për të, por pas gjithë gjasash edhe ky rishtar nuk ka mundur të përfundojë studimet në kolegj.

83. <Nicolaus Bianchi> (= shq. /Nikollë Bardhi/): biri i Domenikut prej Dioqezës së Durrësit; bëri betimin ditën e Rrëshajave (: <Adventus Spiritus Sancti>) 1795. U desh edhe ky të merrte rrugën e kthimit më 1798 sikurse komilitonët e tjerë, shqiptarë e të huaj. (RNCAPF II 88)
84. <Petrus Luphi> (= shq. /Pjetër Lupi/): biri i Ndreut prej Dioqezës së Sapës; bëri betimin të njëjtë datë me Nikollë Bardhin (nr. 83). Shkruesi i dytë shton se është përjashtuar nga kolegji për motive të dobëta, kur kishte filluar të studionte retorikë. (RNCAPF II 89)
85. <Andreas Trascia> (= shq. /Ndre Trasha/): biri i Grigorit prej Dioqezës së Lezhës; bëri betimin më dt. 15 gusht 1793. Tip i vështirë, që u largua nga kolegji ashtu siç edhe hyri: i paprerë për shkollë. (RNCAPF II 94)
86. <Johannes Scura> (= shq. /Gjon Skurra/): biri i Ndoit prej Dioqezës së Durrësit; bëri betimin të njëjtën ditë me Ndre Trashën (nr. 85). I njëjti vlerësim bëhet gjithashtu edhe për Gjonin.
87. <Demetrius Murichi> (= shq. /Dhimitër Murriqi/): biri i Palit prej Dioqezës së Lezhës; bëri betimin të njëjtën ditë me dy të sipërpërmendurit (15 gusht 1793). Ishte tejet i zoti e me sjellje po aq të mira. U largua nga kolegji para grupit të nxënësve që u detyruan të liroheshin prej rrethanave aktuale, pikërisht në maj të vitit 1798, e pasi kaloi dy muaj studimi intensiv në filozofi në Castel S. Angelo, u nis për në atdhe.
88. <Marcus Lindi> (= shq. /Mark Lindi/): biri i Palit prej Dioqezës së Sapës; bëri betimin të njëjtën ditë me tre të sipërpërmendurit (15 gusht 1793); ndodhej në kolegji në vitin 1798, kur të gjithë nxënësit duhej të largoheshin për në atdhe prej dhunës dhe kërcënimit të jetës. Studionte filozofi, të cilën e la përgjysmë. Ishte nxënës me sjellje të mira dhe me aftësi mesatare. (RNCAPF II 96)

Vëzhgim: Kalojmë tash në regjistrimet e kryera në shek. XIX, duke kapërcyer një vakuum kohor për më shumë se dy dekada. (sh. §2.7) Kjo gjë vërehet edhe në mënyrën e regjistrimit (latinisht dhe italisht nga duar të ndryshme) të rishtarëve me të dhënat biografike që parashikohen të pasqyrohen në regjistër:

89. <Joannes Crasnich> (= shq. /Gjon Krasniqi/): rishtar i Dioqezës së Shkupit, lindur më 21 tetor 1804. Hyri në kolegji më 9 prill 1820 në moshën 16 vjeç dhe bëri betimin më dt. 14 prill 1822. Vdiq pasi u shugurua prift më 1830. Kishte formim mesatar, por ishte shpirtmirë dhe i ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e marrë përsipër.
90. <Josephus Bogdan> (= shq. /Zef Bogdani/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Shkupit, lindur më 25 dhjetor 1804. Hyri në kolegji më 9

prill 1820 dhe bëri betimin më 25 prill 1824. U kthye si misionar në dioqezën amë, në misionin e Gjakovës në vitin 1829. Përpos regjistrimit të përgjithshëm (RNCAPF II 129) e ndeshim këtë rishtar edhe në dy katalogë vjetorë (: CACV 1818-1836 dhe CATRCMD 1818-1834), pa mësuar ndonjë të dhënë biografike shtesë për të.

91. <Marcus Ghicra> (= shq. /Mark Qiqra/?): në regjistrin e përgjithshëm lexojmë vetëm të dhënat e tij si rishtar shqiptar i ritit latin, lindur më 14 gusht 1808 e që ka hyrë në kolegji më 29 shtator 1822. Në kohën e regjistrimit studionte në kursin e filozofisë. (RNCAPF II 143)
92. <Petrus Zarisci> (= shq. /Pjetër Zarishi/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Sapës, i lindur më 1808. Hyri në kolegji më 14 dhjetor 1822 dhe bëri betimin më 25 prill 1828. Shugurohet prift më 8 korrik 1831, pasi ka kaluar në të gjitha fazat e formimit meshtarak. Në fund të studimit iu nënshtrua provimit kryesor në teologji, të cilin e mbylli me sukses. Dallohej për zgjuarsin e lindur, veçse ishte djalosht i sertë, se nuk u bindej lehtë këshillave të autoriteteve e nuk i shmangej kollaj gjyqimit të vet personal, duke nënçmuar atë të tjerëve. Nuk donte të dinte as për këshillat dhe paralajmërimet që i bënë eprorët (RNCAPF II 194) Emrin e tij me informacione të thukëta e ndeshim edhe në CACV 1818-1836, CACV 1819-1837 dhe CATRCMD 1818-1834, nga ku mësojmë që është larguar me mision në dioqezën amë në nëntor 1832.
93. <Antonius Sc(h)eldia> (= shq. /Ndue Sheldia/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Shkodrës, lindur më 19 nëntor 1808. Hyri në kolegji më 14 dhjetor 1822, ndërsa betimin e bëri më 25 prill 1828. Në motet akademike ndjekëse studioi dy vjet filozofi (1830-1831) dhe dy të tjerë teologji (1832-1833). I kaloi në kolegji me sukses të gjitha fazat e formimit meshtarak me shkallët përkatëse (: tonsurën; 4 urdhrat minorë etj.) U largua nga kolegji më 13 gusht 1833. (RNCAPF II 194) Emrin e tij me të njëjtat informacione të thukëta e ndeshim edhe në CACV 1818-1836, CACV 1819-1837, CACV 1819-1837 dhe CATRCMD 1818-1834.
94. <Gasparus Crasnich> (= shq. /Gaspër Krasniqi/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Shkupit, i lindur më 14 mars 1812. Hyri në kolegji më 14 mars 1825 dhe bëri betimin më 29 qershor 1830. Ai studioi logjikë deri në vitin 1829, fizikë më 1830-1831 dhe më pas katër vjet teologji në vitet 1832-1835. Provimin kryesor e mbylli me sukses, sikurse të gjitha fazat e formimit meshtarak. U largua si misionar apostolik në dioqezën amë në shtator 1835. Ishte nxënës i zellshëm, por paksa kryeneç e donte të vepronte siç i thoshte mendja e vet. Veçse vitet e

fundit pati përmirësime të dukshme në këtë drejtim. (RNCAPF II 198). Informacione të shkurtra, por të njëjta me ato më lart i qëmtuam gjatë shfletimit të CACV 1818-1836; CACV 1818-1837 dhe CACV 1819-1837.

95. <Georgius Tuscia> (= shq. /Gjergj Tusha/): e këqyrim këtë emër vetëm në CACV 1818-1837 (përsëritur edhe në CACV 1820-1837) si rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Durrësit, i lindur po në Durrës në vitin 1810. Hyri në kolegji në vitin 1823, por nuk jetoi gjatë. Vdiq dy vjet më pas, në vitin 1825 prej një goditjeje në tru (apoplexis).
96. <Joannes Crasnich> (= shq. /Gjon Krasniqi/): e lexojmë këtë emër vetëm në CACV 1818-1836 (përsëritur edhe në CACV 1820-1837) si rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Shkupit, i lindur më 21 tetor 1804. Hyri në kolegji më 9 prill 1820 dhe betimin e bëri dy vjet më vonë, më 14 prill 1822. Por s'qëndroi gjatë se u sëmur nga tuberkulosi (phthisis), kështu që mjekët e nisën për në atdhe në vitin 1825, ku vdiq i shuguruar prift në vitin 1830.
97. <Paulus Dodmassei> Pal Dodmasi: rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Shkodrës, i lindur po në Shkodër më 17 qershor 1814. Hyri në kolegji më 21 korrik 1826 dhe bëri betimin tre vjet më vonë, më 29 qershor 1830. Vitet 1829-1830 studioi retorikë, 1830-1832 logjikë dhe 1832-1833 fizikë. Më pas përfundoi me shumë sukses kursin katërvjeçar të teologjisë (1833-1837). Shkallët e para të shugurimeve të vogla (: subdiakonatin dhe diakonatin) i ngjiti në vitin 1836, ndërsa atë të priftit në vitin 1837 prej ipeshkvit të vet Alberto Albertini. Kthehet për të misionuar në dioqezën amë më dt. 8 prill 1837. Ishte njeri inteligjent dhe dashamir. Atë që ia thosh mendja e zemra e shprehte pa menduar gjatë edhe me fjalë, çka nuk iu mor asnjëherë për ters. (RNCAPF II 203) Është kjo një ndër arsytet përse i ngjiste fjala, andaj ngjiti shpejt edhe shkallët e karrierës në atdhe, fillimisht si vikar i përgjithshëm dhe kapitular i Dioqezës së Durrësit, më pas si ipeshkëv i Pultit (30 korrik 1847),⁵⁶ duke vijuar më vonë atë të Lezhës (1 qershor 1958), ku edhe vdiq në detyrë në rezidencën e vet në Kallmet më 27 shtator 1868.⁵⁷ Të dhënat biografike themelore janë të regjistruara edhe në CACV 1819-1837; APCUPF 1837-1847.

56 "Promovetur ad Pulaten. (S. Br. 5119 f. 46-47'), iuxta decr. S. Congr. Prop. 26 iul. 1847 emanatum (l.c. f. 48); nat. in civ. Scutaren. 17 iun. et 1814 (*Ann. Pont.* 1863 p. 120), alumnus coll. Urbani Romae, discessit e dicto coll. 8 apr. 1837 (A. Prop. 207 f. 324'), vic. gen. et cap.^{ris} Dyrrachien., modo rector sem. Scutaren. (l.c. 210 f. 411'); consecr. in civ. Scutaren. 30 nov. 1847 a carolo eo. Maronien. et admin. apost. Antibaren. (Albania 32 f. 900); tr. ad Alexien. 1 jun. 1858." (Eubel VII 472)

57 "Absolv. a vinc. Pulaten. tr. ad Alexien. (S. Br. 5309 f. 333-333'), iuxta decr. S. Congr. Prop. 16 maii 1858 emanatum (l. c. f. 335); ob. in sua resid. Calmeti 27 sept. 1868 (Scrittura 997 f. 548)." (Eubel VII 88)

98. <Angelus Babbi> (= shq. /Engjëll Babi/) rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Sapës, lindur më 13 maj 1815. Hyri në kolegji më 25 qershor 1834 dhe më 2 shkurt 1836 bëri betimin. Studioi gramatikë në vitet 1835-1836, retorikë në vitet 1836-1837, filozofi në dy kurset e viteve 1838-1840. Më pas studioi teologji për katër vjet. Në kolegji mori katër urdhrat minorë dhe ngjiti shkallët e karrierës meshtarake duke u shuguruar prift më 25 mars 1844. U largua si misionar apostolik për në atdhe më 13 maj 1844, ditën që mbushi 29 vjeç. (RNCAPF II 251) Grimca biografike për personin e tij i mësojmë në CACV 1819-1837; CACV 1837; APCVPF 1837-1847.

99. <Joannes Spattari> (: shq. /Gjon Spatari/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Shkodrës, lindur po në këtë qytet më 10 dhjetor 1816. Hyri në kolegji më 26 qershor 1834 dhe bëri betimin dy vjet më vonë, më dt. 2 shkurt 1836. Studioi gramatikë në vitin shkollor 1835-1836, retorikë në 1836-1837, filozofi deri në 1839 dhe më pas teologji deri në vitin 1844. I mori urdhrat minorë në vitin 1839 dhe u shugurua prift më 25 mars 1844. U largua me mision apostolik për në atdhe më 13 maj 1844. (RNCAPF II 251) Grimca biografike shtesë mësojmë në disa katalogë vjetorë të kolegjit, ndër ta: CACV 1819-1837; CACV 1837; APCVPF 1837-1847.

100. <Giovanni Suggi> (= shq. /Gjon Suxhi/ ?): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Sapës, lindur në Kodhel më 30 nëntor 1816. Hyri në kolegji në dt. 8 prill 1835. Në vitet shkollorë 1835-1838 studioi gramatikë, 1838-1839 retorikë si edhe humanistikë më 1839-1840. Rreth këtij viti të dytë të kursit të retorikës dhe humanistikës u sëmur rëndë nga lija (: <variolis>). Në vitet 1841 dhe 1842, kur studionte filozofi, u kuptuan paaftësitë e tij në studim dhe se gjykonte ters dhe dëmshëm, andaj edhe u lirua nga kolegji. Më 2 shkurt 1841 kishte bërë betimin. (RNCAPF II 266; CACV 1819-1837; CACV 1837; APCVPF 1837-1847)

101. <Michael Summa> (= shq. /Mëhill Suma/ ~ /Mikel S./): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Sapës, lindur në Krajinë në 1819. Hyri në kolegji më dt. 8 prill 1835 dhe studioi deri në vitin 1838 gramatikë në nivelin e ulët. Nuk ishte i zoti për më shumë, andaj iu ndërpre qëndrimi dhe u dërgua për në atdhe më 25 janar 1840. (RNCAPF II 266; CACV 1819-1837; CACV 1837)

102. <Jacobus Sorba> (= shq. /Jak Zorba/): rishtar i shkodran i ritit latin (i dërguar) prej Dioqezës së Tivarit, lindur më 8 shkurt 1819 në Shkodër. Hyri në kolegji më 9 shkurt 1836. Studionte gramatikë në vitet 1836-1837, kur iu tek të shkonte për vizitë në atdhe. U kthye rishtas në Romë dhe hyri aty në Konventin e Fretërve Françeskanë. (RNCAPF II

276; CACV 1819-1837; CACV 1837)

103. <Augustinus Radovani> (= shq. /Agustin Radovani/): rishtar i shkodran i ritit latin (i dërguar) prej Dioqezës së Tivarit, lindur më 15 shkurt 1819 në Shkodër. Hyri në kolegji bashkë me Jak Zorbën (nr. 102) 9 shkurt 1836. Studioi gramatikë të nivelit të ulët në vitet 1836-1838, dhe të nivelit të lartë më 1839. Në vitin 1840 filloi të studioje humanistikë, dukë bërë më pas edhe betimin më 2 shkurt 1841. (RNCAPF II 277). Nga katalogët vjetorë mësojmë gjithashtu që më 22 prill 1847 u nis misionar për në atdhe, pasi i kishte përfunduar studimet. (CACV 1819-1837; CACV 1837; APCVPF 1837-1847). Duhet të ketë qenë i regjur edhe në punë letrash shqip, meqë hyn dorëzanë së bashku me Mark Gallatën (nr. 104) lidhur me përmbajtjen e patëmetë të tekstit të librit /Ruga e Parrizit .../ me autor Vincenzo Basile SJ (Romë 1845 – shih Demiraj 2017d 37)
104. <Marcus Galata> (= shq. /Mark Gallata/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Lezhës, lindur më 27 maj 1821. Hyri në kolegji në dt. 17 mars 1836 dhe bëri aty betimin më 2 shkurt 1841. Më 8 janar 1846 u nis misionar për në atdhe. (APCUPF 1837-1847; CACV 1837 – mungon në regjistrin e përgjithshëm) Bashkë me Agustin Radovanin (nr. 103) firmos *nihil obstat* të veprës shqip /Ruga e Parrizit .../ me autor Vincenzo Basile SJ (Demiraj 2017d 37)
105. <Antonius Murichi> (= shq. /Ndue Muriqi/): edhe ky rishtar nuk na del i regjistruar në regjistrin e përgjithshëm, madje e ndeshim vetëm një herë në katalogun vjetor CACV 1837 (f. 10-11) si rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Lezhës që lindi në qershor të vitit 1826 dhe se hyri në kolegji më 17 maj 1836, pra në moshën 12 vjeç, kur fillon të studiojë gramatikë të nivelit të ulët. Nuk kemi mundur të fitojmë më shumë informacion se kaq.
106. <Paulus Beriscia> (= shq. /Pal Berisha/): edhe emri i këtij rishtari nuk është përfshirë në regjistrin kryesor, por e ndeshim në disa katalogë të tjerë. Në ta mësojmë të ketë qenë nxënës i ritit latin prej Dioqezës së Shkupit, lindur më 15. dhjetor 1821 në Prizren. Hyri në kolegji më 2 gusht 1836 dhe bëri betimin më 2 shkurt 1838. Në vitin shkollor 1741 studioje ende gramatikë. Veçse më 22 prill 1847 rezulton të ketë mbaruar studimet e të jetë nisur si misionar në vendlindje. (APCVPF 1837-1847; CACV 1837) Gjatë karrierës baritore arriti të ngjiste katedrën e Dioqezës së Pultit më 14 qershor 1864. Ky fakt na lejon të mbledhim më shumë informacion për personin e tij te Eubel (VIII 472), ku mësojmë, ndër të tjera se: misionoi për shumë vjet si famullitar në Crnagorë (Karadak/Kosovë) dhe konaskrimin si ipeshkëv e përjetoi

në Shkodër, celebruar prej Karl Pooten, arqipeshkëv i Tivarit. Vdiq në selinë e tij në Perast (: <Berasta>) të Pultit më 21 gusht 1869.⁵⁸

107. <Petrus Tacci> (= shq. /Pjetër Taçi/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Shkupit, lindur më 9 nëntor 1918. Hyri në kolegji më 2 gusht 1736. Në vitin 1839 studioi në kursin e lartë të gramatikës. Më pas vijoi me humanistikën (1839-1840). U rëndua nga shëndeti dhe me këshillë të natyrës vendimore të tre mjekëve u lirua nga kolegji për t'u kthyer në atdhe më dt. 26 janar 1841. U kthye përsëri në kolegji më 1845 me dëshirën e madhe që të përfundonte studimet. Gjithsesi tuberkulozi bëri të vetën: vdiq një vit më vonë më 1846 në Romë. (RNCAPF II 281; CACV 1837: <Facci> për <Tacci>)
108. <Antonius Sclaku> (= shq. /Ndue Shllaku/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Shkodrës, lindur më [... bosh – B.D.]. Hyri në kolegji më 8 maj 1845. Shkruesi në regjistrin kryesor shton se ky nxënës u sha e u qortua aq shumë prej një ati (padre – në kolegji), sa s'duroi më e mori rrugët drejt e te pashai turk, duke dashur doemos t'u bashkohej turqve. Mezi ia doli konsulli austriak, Kalorësit Antonio Ballerini për t'i ndërruar mendjen. Fshehtas e ktheu Ndoin kokëshkretë në Romë dhe duke u marrë parasysh këto rrethana të pazakonshme u lejua të vijojë studimet. (RNCAPF II 349) Këtë emër e hasim ndër të tjera edhe në një katalog vjetor (ASPF APCVPF 1848: nr. 69), ku lexohen të dhënat biografike kryesore si më sipër, por edhe me shënimin se më 13 prill 1848 “discessit adv. valetud.” Në (ASPF) CP Coll Urbano vol. 20 (Alumni 1858, nr. 66 – fol 430vv.), lexojmë gjithashtu se Ndoi ynë në vitin 1855 studionte humanistikë.
109. <Recci Augustinus> (= shq. /Agustin Reçi/): rishtar i shkodran i ritit latin, dërguar në kolegji prej Dioqezës së Shkodrës, lindur më 3 dhjetor 1833. Hyri në kolegji në korrik 1846, duke studiuar aty për 12 vjet rresht të gjitha kurset e mundshme, deri më 1858, kur e shohim të studionte teologji në vitin e katërt. (RNCAPF II 360; APCVPF 1848, f. 8-9; ... 1849, f. 6-7; ... 1850, f. 6-7; ... 1851, f. 8-9; ... deri ... 1858; CP Coll Urbano vol. 20, fol 228vv. (Alumni 1856) fol 360 vv. (Alumni 1857) fol 430vv (Alumni 1858))

Vëzhgim: Emrat e rishtarëve që vijnë nuk janë të regjistruar në regjistrin e përgjithshëm (RNCAPF II) të Kolegjit Urban. Këta të pakë rishtarë

58 “Promovetur ad Pulaten. (S. Br. 5403 ff. 398-398’), iuxta decr. S. Congr. Prop. 9 iun. 1864 emanatum (l.c. f. 48); nat. in Priserendi diaec. Scopien. 15 dec. 1821, ingressus in coll. Urbanum Romae 2 aug. 1836, praestitit iuramentum 2 febr. 1838, discessit e coll. 22 apr. 1847, modo parochus in Zernagora diaec. Scopien. (A. Prop. 228 ff. 3, 5’), consecr. in civ. Scutaren. 28 aug. 1864 a Carolo archiep. Antibaren. (Albania 38 f. 574); ob. in Berasta dioec. Pulaten. 21 aug. 1869 (Scritture 997 f. 574)” (Eubel VII 472)

kemi mundur t'i përzgjedhim si më lart (nr. 109) gjatë hetimit aspak të lehtë e komod të katalogëve vjetorë dhe listave të çfarëdo lloji në ACU dhe ASPF.

110. <Andreas Logorezzi> (= shq. /Ndre Logoreci/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Shkodrës, lindur më 25 tetor 1830. Hyri në kolegji më 14 korrik 1850, duke filluar menjëherë në kursin e parë të filozofisë. Betimin e kreu më 2 korrik 1851. Pas dy vjetësh studimi të rregullt në filozofi, vijonë katër vite studimi në teologji (1853-1856), përfundimi i suksesshëm i të cilave mundësoi natyrshëm shugurimin e tij dhe më 18 prill 1856 nisët me mision apostolik në dioqezën amë. (APCVPF 1850, f. 6-7; ...1851, f. 8-9; ... deri ... 1856, f. 2-3; CP Coll Urbano vol. 20, fol 228vv. (Alumni 1856) Për aktivitetin e tij klerikal, që arriti një pikë kulmore me zgjedhjen e tij si arqipeshkëv i Shkupit (1888-1892) si edhe me vendin e tij në kulturën e shkrimit shqip me disa botime të natyrës katekistike, jemi marrë hollësisht në një punim të veçantë (Demiraj 2017c)
111. <Marcus Soppi> (= shq. /Mark Sopi/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Shkupit, lindur në Binçë më 15 janar 1828. Hyri në kolegji më 13 shtator 1851, kur fillon të studiojë në kursin e ulët të gramatikës, duke vijuar me radhë edhe kurset e tjerë deri në vitin 1859, kur largohet për në dioqezën amë i shuguruar prift. (APCVPF 1851, f. 10-11; ... deri ... 1859, f. 2-3; CP Coll Urbano vol. 20, fol 228vv. (Alumni 1856) fol 360 vv. (Alumni 1857) fol 430vv (Alumni 1858); fol 504vv (Alumni 1859))
112. <Paschalis Lalpepai> (= shq. /Paskal Lalpepaj/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Durrësit, lindur në Selitë (? <Selicta>) më 10 mars 1840. Hyri në kolegji më 5 qershor 1855 dhe e ndeshim gjithkund në regjistrat vjetorë, deri në atë të vitit 1864, kur studionte teologji në vitin e parafundit e duke pasur gjithherë statusin e ndihmësmeshtarit (<acolythus>) Më tej s'kemi pasur mundësi ta gjurmojmë këtë emër. (APCVPF 1856, f. 10-11, ... deri ... 1864, f. 1-2)
113. <Antonius Tuscij> (= shq. /Ndue Tusha(j)/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Durrësit, lindur në Kthellë më 8 shtator 1843. Hyri në kolegji më 30 shtator 1857, ndërsa betimin e bëri më 29 qershor 1863. E ndeshim së fundi në regjistrat e viteve 1863 dhe 1864, kur studion në kurset e filozofisë të vitit të parë e të dytë. Nuk kemi mundur të mësojmë më shumë lidhur me mbarëvajtjen e këtij rishtari në kolegji. (APCVPF 1858, f. 12-13; ... 1859, f. 10-11, ... 1863, f. 4-5; ... 1864, f. 1-2; CP Coll Urbano vol. 20, fol 430vv (Alumni 1858); CP Coll Urbano vol. 20, fol 504vv (Alumni 1859))
114. <Ioachim Brigniai> (= shq. /J. Brinjaj/): rishtar i ritit latin prej

Dioqezës së Durrësit, lindur në Bishkash më 22 tetor 1845. Hyri në kolegji më 30 shtator 1857, ndërsa betimin e bëri më 29 qershor 1865. E ndeshim rregullisht në katalogët vjetorë të kolegjit, deri në vitin 1870, kur studion në vitin e katërt të kursit të teologjisë, duke u shuguruar prift. Më 8 prill 1870 nisët për në dioqezën amë në mision apostolik. (APCVPF 1858, f. 12-13; ... 1859, f. 10-11, ... 1863, f. 4-5; ... 1864, f. 1-2; ... deri ... 1870, f. 2-3; CP Coll Urbano vol. 20, fol 430vv (Alumni 1858); CP Coll Urbano vol. 20, fol 504vv (Alumni 1859))

115. <Primus Dochi> (= shq. /Primo Doqi/ ~ /P. Doshi/?): [...] rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Lezhës, lindur Bujgër (<Bulgari>) më 7 shkurt 1846. Hyri në kolegji më 18 dhjetor 1861 me bursën Barberini. Betimin e ka bërë më 1 nëntor 1866. Kemi mundur të gjurmojmë mbarëvajtjen e këtij rishtari në kolegji deri në vitin 1870, kur studionte teologji në vitin e tretë. (APCVPF 1863; ... deri ... 1870, f. 2-3)

116. <Antonius Melgusci> (= shq. /Ndue Melgushi/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Lezhës, lindur Kashnjet (<Castagneti>) më 7 janar 1849. Hyri në kolegji sikurse komilitoni i tij Primo (nr. 115) më 18 dhjetor 1861 me bursën Barberini. Pas gjase nuk i ka çuar studimet deri në fund, sepse nuk del më në katalogët e viteve 1869, 1870 si komilitoni i tij. (APCVPF 1863, f. 6-7 ... deri ... 1865, f. 6-7: studion retorikë dhe s'ka bërë ende betimin)

117. <Josephus Bianchi> (= shq. /Zef Bardhi/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Sapës, lindur më 8 mars 1860 dhe hyn në kolegji më 21 tetor 1872. E ndeshim rastësisht në regjistrin e vitit 1875, kur studion në kursin e humanistikës. (PCVPF 1875, f. 6-7). Nuk e kemi ndjekur më afër mbarëvajtjen e tij në kolegji.

118. <Cuculla, Joachimus> (= shq. /Gjon Kukulla/): rishtar i ritit latin prej Dioqezës së Durrësit, lindur në Skurraj më 4 prill 1858. Hyri në kolegji më 31 maj 1873 me bursën Barberini. Në regjistrin e vitit 1875 rezulton të ndjekë kursin e retorikës. (PCVPF 1875, f. 8-9) Si në rastin e mësipërm, nuk e kemi ndjekur më afër mbarëvajtjen e tij në kolegji.

Vëzhgim: Kemi mbyllur këtu regjistrimin e rishtarëve shqiptarë në kolegji, të cilët vijojnë ende të pranohen, paçka se në numër gjithnjë e më të reduktuar, meqë, siç vumë në dukje më lart (§1), me themelimin e Kolegjit Saverian në Shkodër krijohen edhe në truall shqiptar mundësitë e formimit të plotë intelektual-fetar.

Bibliografi

I. Burime arkivore me shkurtime përkatëse

ACU = Archivio del Collegio Urbano

ASPF = Archivio Storico de Propaganda Fide

a) *Regjistra katalogë në ACU (& ASPF)*

APCVPF 1837-1847 = (drsh.) Alumni Pontificii Collegii Urbanii de Propaganda Fide qui ab anno 1837. ad annum 1847 inclus. ad Fidem prpagandam missi fuerunt [Sig. ACU – Archivio – *Storia* 3/2 VI. 1/2]

APCVPF 1848 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCXLVIII.

APCVPF 1849 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCXLIX.

APCVPF 1850 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCL.

APCVPF 1851 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCLI.

APCVPF 1852 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCLII.

APCVPF 1853 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCLIII.

APCVPF 1854 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCLIV.

APCVPF 1855 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCLV.

APCVPF 1856 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCLVI.

APCVPF 1857 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCLVII.

APCVPF 1858 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCLVIII.

APCVPF 1859 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCLVIII.

APCVPF 1863 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCLXIII.

APCVPF 1864 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCLXIV.

APCVPF 1869 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCLXIX.

APCVPF 1870 = Alvmni Pontificii Collegii Vrbanii de Propaganda Fide. Anno MDCCCLXX.

- CACV 1818-1836 = (drsh.) Catalogus Alumnorum Collegii Urbani de Propaganda Fide qui ab Anno 1818. in quo Collegium fuit restitum ad annum 1836 inclus. ad Fidem propagandam missi fuerunt. [Sig. ACU – Archivio – *Storia* 3/2 VI. 1/2]
- CACV 1819-1837 = Catalogvs Alvmnorum qvi ab Anno MDCCCXIX. ad MDCCCXXXVII. e Collegio Vrbano ad Fidem propagandam missi fverunt.
- CACV 1818-1837 = Catalogvs Alvmnorum qvi ab Anno MDCCCXVIII. ad MDCCCXXXVII. e Collegio Vrbano ad Fidem propagandam missi fverunt.
- CACV 1819-1837 = Catalogvs Alvmnorvm Collegii Vrbani qvi ab Anno MDCCCXIX ad MDCCCXXXVII. Vel jam prodiervnt. Vel adhuc institvntvr. Ex Typographeo Collegii Vrbani. [Sig. ACU – Archivio – *Storia* 3/2 VI. 1/2]
- CACV 1820-1837 = Catalogvs Alvmnorum Collegii Vrbani de Propaganda Fide qvi ab an. MDCCCXX. ad MDCCCXXXVII tvn intra extra Collegium vivere desiervnt.
- CACV 1837 = Catalogus Alumnorum qvi anno MDCCCXXXVII in Collegio Vrbano institvntvr.
- CATRCMD 1818-1834 = Catalogus Alumnorum qui a tempore restituti collegii in missionibus discesserunt ab anno MDCCCXVIII usque ad initium anni MDCCCXXXIV [Sig. ACU – Archivio - *Storia* 3/2 VI. 1/3]
- CAVCV 1747 = (drsh.) Catalogo degli Alunni del Venerabile Collegio Urbano de Propaganda Fide per l'Anno 1747 del tempo del Padre Idelfonso di S. Carlo delle Scuole Pie. Rettore dell'anno corrente. [Sig. ACU – Archivio – *Storia* 3/2 VI. 1/2]
- CAVCV 1749 = (drsh.) Catalogo degli Alunni del Venerabile Collegio Urbano de Propaganda Fide per l'Anno 1749 del tempo del Padre Idelfonso di S. Carlo delle Scuole Pie. Rettore dell'anno corrente. [Sig. ACU – Archivio – *Storia* 3/2 VI. ½]
- CAVCV 1750 = (drsh.) Catalogo degli Alunni del Venerabile Collegio Urbano de Propaganda Fide per l'Anno 1750 del tempo del Padre Idelfonso di S. Carlo delle Scuole Pie. Rettore dell'anno corrente. [Sig. ACU – Archivio – *Storia* 3/2 VI. 1/2]
- CAVCV 1756 = (drsh.) Catalogo degli Alunni del Venerabile Collegio Urbano de Propaganda Fide per l'Anno 1756 del tempo del Padre Idelfonso di S. Carlo delle Scuole Pie. Rettore dell'anno corrente. [Sig. ACU – Archivio - *Storia* 3/2 VI. 1/2]
- CAVCV 1761 = (drsh.) [Sig. ACU – Archivio - *Storia* 3/2 VI. 1/2]
- PCVPF 1875 = Ponitficvm Collegivm Vrbavm de Propaganda Fide. Anno MDCCCLXXV [Sig. ACU – Archivio - *Storia* 3/2 VI. 1/3]
- RNCAPF = Registro dei nomi, Cognomi, etc. degli alunni di Propaganda

Fide raccolti dal Rettore Bonvicini: ordinato poi il tutto da L. IC
Figari SJ

b) Libri i betimeve

Giur. II = Libro dei Giuramenti (Collegio Urbano)

c) Akte në ASPF

CP Coll Urbano vol. 20.

SOCG vol. 361 (: Collego de Prop. Fide. – Alumni); 379.

II. Literaturë e cituar

Eubel, Conrad (~ Ritzler, Remigium et Sefrin, Pirminum)

IV-VIII Hierarchia Catholica Medii et Recentioris Aevi, vol. IV (1592-1667), Regensburg 1935: vol. V (1667-1730), Patavii 1952; vol. VI (1730-1799), Patavii 1957; vol. VII (1800-1846), Patavii 1958; vol. VIII (1846-1903), Patavi 1979.

Farlati, Daniele & Coleti, Jacopo:

VII Illyricum sacrum, t. VII. Venetiis 1817.

VIII Illyricum Sacrum, t. VIII. Venetiis 1819.

Bartl, Peter

1975 Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert, Bd. I, në Serinë „Albanische Forschungen“ Nr. 15, Wiesbaden.

Demiraj, Bardhyl:

2006 Gjon P. Nikollë Kazazi dhe “Doktrina” e tij, Prishtinë.

2013 Jeta dhe trashëgimia e Gjon P. Nikollë Kazazit. Shkodër.

2015 Jetë rishtarësh shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Fermos, në: “Hylli i Dritës” 1-2, 426-428.

2016a Grimca biografike për autorët tanë të vjetër. I. Frang Mark Bardhi (1606-1643), në: „Hylli i Dritës“ 1, 7-16.

2016b Grimca biografike për autorët tanë të vjetër. III. Rinia dhe formimi teologjik-intelektual i Pjetër Bogdanit, në: “Hylli i Dritës” 2, f. 20-40, Shkodër.

2016c Damnatio memoriae vs. laudatio funebris – dy shfaqje të ‘tranzicionit’ intelektual në Enciklopedinë Shqiptare, në: “Milosao” – Supplement i “Gazeta shqiptare” nr. 239 (26.06.2016) 1-5; dhe nr. 240 (03.07.2016) 2-5, Tiranë.

2016d Rishtarë shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Loretos. Pjesa I: Përshkrim kulturor-historik, në: “Shëjzat - Le Pleiadi” (Series nova) 3-4, 48-85, Shkodër.

2016e Letra enciklike “Inter Omnigenas” e Papë Benediktit XIV (2 shkurt 1744) dhe roli i Imz. Gjon P. Nikollë Kazazit në përftimin e saj, në: “Shëjzat” (Series nova) 1-2 [2016] 92-106. Tiranë.

- 2017a Rishtarë shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Loretos. Pjesa II: Klasifikimi i dokumentacionit arkivor, në: "Shêjzat - Le Pleiadi" (Series nova) 1-2 (30 f. – në shtyp)
- 2017b Grimca biografike mbi autorët tanë të vjetër (VI): Gjergj Engjëll Radovani (1733 – 1790), në: "Hylli i Dritës" 1, 17-29.
- 2017c Ndre Logoreci (1830-1892) – në kulturën e shkrimit shqip të arealit kulturor të Veriut. (në shtyp)
- 2017d Grimca biografike për autorët tanë të vjetër. VII. Vincenzo Basile SJ (1811 - 1882), në: "Hylli i Dritës" 1, 30-49.
- Jezernik, Maksimilijan
- 1971 Il Collegio Urbano, në: „Sacrae Congregationis de Propaganda Fide Memoria Rerum. 350 Anni a servizio delle missioni. 1622-1972, vol. I/1, 1622-1700, Rom - Freiburg - Wien 1971, f. 465-482.
- 1972 Il Collegio Urbano, në: „Sacrae Congregationis de Propaganda Fide Memoria Rerum. 350 Anni a servizio delle missioni. 1622-1972, vol. II, 1700-1815, Rom - Freiburg - Wien 1973, f. 283-299.
- 1975 Collegio Urbano, në: „Sacrae Congregationis de Propaganda Fide Memoria Rerum. 350 Anni a servizio delle missioni. 1622-1972, vol. III/1, 1815-1972, Rom - Freiburg - Wien 1975, f. 99-123.
- Peters, Markus E.
- 2007 Der älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung, Bildung und Kultur. Die "Buchdruckerei der Unbeflecten Empfängnis" zu Shkodra (1870-1945), Hamburg 2007)Der älteste ...
- Roques, Mario
- 1932a Le Dictionaire albanais de 1635, édité avec introduction et index complet (par M. Roques). Dictionarium latino-epiroticum per R. D. Franciscum Blanchum, Paris.
- 1932b: Recherches sur les anciens textes albanais, Paris.